

UNITED NATIONS  
United Nations  
Interim  
Administration  
Mission in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission  
d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo

KUVENDI I KOSOVËS СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO

# BULETINI

Shkurt, 2005 Nr.7



Zyra për Marrëdhënie me Media dhe Publikime e Kuvendit të Kosovës

**KRYEPARLAMENTARI DACI PRITI  
SHEFIN E UNMIK-UT PETERSEN**

# Porositë e Tadiqit nuk ua lehtësojnë jetën serbëve

*Është biseduar për vizitën e presidentit serb  
Tadiq dhe për të arriturat në përbushjen e  
standardeve për Kosovën*



*Takimi Daci - Petersen*

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, ka pritur sot PSSP të OKB-së në Kosovë, Soren Jeseen-Petersen dhe ka biseduar me te për vizitën e presidentit të Serbisë Boris Tadiq në Kosovë dhe për të arriturat e deritashme të Kosovës në përbushjen e standardeve.

Kryeadministratori Petersen ka shprehur kënaqësinë që vizita ka kaluar pa ndonjë incident dhe se atë e kanë përcjellë profesionalisht gazetarë serbë nga Beogradi dhe gazetarët shqiptarë. Kjo vizitë, ka thënë Petersen, e ka kthyer Kosovën në fokus të interesimeve, ndërkaq kryeadministratori ka shfaqur pakënaqësinë që Tadiq e ka ndryshuar agjendën e tij për çka ishin marrë vesh.

Porositë që u ka sjellë zoti Tadiq serbëve të Kosovës, nuk ua lehtësojnë jetën atyre dhe nuk iu ndihmojnë të integrohen në institucionet dhe në shoqërinë e Kosovës, përkundrazi, është shprehur kryeparlamentari Daci.

Kreu i legjislativit të vendit është shprehur i vendosur për përbushjen e standardeve dhe në këtë kuadër edhe të realizimit të shtatë projekt-komunave në Kosovë, projekt të cilin është shprehur Petersen e ka përkrahur edhe Ministria e Pushtetit Lokal.

Pas takimit PSSP të OKB-së në Kosovë, Soren Jeseen-Petersen u ka pohuar gazetarëve se i ka bërë ftesë kryeministrit Haradinaj ta shoqërojë në vizitën e tij në Nju -Jork.

Daci, ndërkaq, është shprehur i gatshëm të dialogojë për çështje me interes për qytetarët dhe për projekte të mëdha të Paktit të Stabilitetit, siç janë rrugët dhe çështjet energjetike, por është shprehur i prerë se me Beogradin nuk do të dialogohet çështja e statusit të Kosovës. Statusi i vendit është çështje e institucioneve të Kosovës dhe e bashkësisë ndërkombëtare, ka thënë Daci.



## PËRMBAJTTJA:

- U zgjodhën bartësit e funksioneve më të larta të vendit ..... 3**
- Ndihma amerikane për mbarëvajtje të proceseve zhvillimore në Kosovë është e një rëndësie të veçantë..... 10**
- Udhëheqja e Kosovës do të plotësojë kriteret për statusin final të vendit..... 10**
- Mbështetje pa hezitim për frymëmarrje të lirë të biznesit..... 11**
- Ekonomia, shëndetësia, siguria dhe shteti ligjor meritojnë përkushtim të veçantë ..... 13**
- Zbatimi i planit të standardeve - përkushtim operativ dhe ditor i Qeverisë ..... 15**

### Redaksia:

**Sharif Konjufca, Shefqet Rexhepi, Celal Ilyas, Edona Fetahu**

Telefonat Kontaktues:

**038\ 211 186, 038\ 211 949, 038\ 211 189, 044\ 127 921**

Tel/Fax: **038 211 188**

**E-mail:**

media@assembly-kosova.org

**Web faqja:**

[www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

# U zgjodhën bartësit e funksioneve më të larta të vendit

*Petersen : Është përgjegjësi edhe e të gjithë juve që ta bëni Kosovën një vend më të mirë për të gjithë qytetarët që jetojnë në të.- Bartja e kompetencave ka kuptim vetëm nëse shpie drejt veprimeve produktive dhe pozitive*

Mbledhja Konstituive e Kuvendit të Kosovës u mbajt më 3 dhjetor të vitit 2004. Seancën e udhëheqi deputeti më i vjetër për nga mosha i Kuvendit të Kosovës, akademik Mark Krasniqi, ndërsa bashkëkryesuese ishte Nekibe Kelmendi, deputete e Kuvendit të Kosovës. Kryesuesi Mark Krasniqi në fillim iu uroi mirëseardhje dhe punë të mbarë deputetëve të legjislaturës së re, duke përshëndetur edhe mysafirët e lartë vendës e ndërkombëtarë.

Para se të fillojë pjesa tematike e rendit të ditës, u ftua Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, **Soren Jessen Petersen**, që t'iu drejtohet deputetëve me një fjalë rasti.

Pasi përshëndeti deputetët dhe mysafirët, z. Petersen theksoi se ndihet shumë i nderuar që merr pjesë në këtë Seancë inauguruese. Ai pastaj falënderoi Qeverinë të udhëhequr nga kryeministri Rexhepi për punën që ka bërë gjatë viteve të fundit.

Kjo Qeveri, theksoi Petersen, ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në ngritjen e çështjeve të rëndësishme për Kosovën, ka bërë përparim të rëndësishëm dhe ka mundur rimëkëmbje pas dhunës së tmerrshme që ka ndodhur në mars.

## **Përgjegjësi e madhe ndaj votueseve dhe Kosovës**

Zgjedhjet e tetorit që ju kanë sjellë juve këtu, kanë qenë të lira e të drejta dhe janë udhëhequr në mënyrë të qetë. Kjo është meritë e Kosovës. Seanca e sotme është fryt i këtij procesi demokratik.

Si anëtarë të organit më të lartë, përfaqësues legjislativ të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, ju keni një përgjegjësi shumë të rëndësishme, jo vetëm ndaj votuesve tuaj që ju kanë dhënë besimin, por edhe ndaj Kosovës. Ju keni përgjegjësi që të merrni vendime të vetëdijshme, të cilat do të jenë në interes të mbarë Kosovës.

Sapo u ktheva nga Nju-Jorku, ku kam informuar Këshillin e Sigurimit lidhur me situatën në Kosovë, duke përfshirë edhe vlerësimin tonë lidhur me përparimin e bërë deri më tani, si dhe me rrugën që gjendet para nesh. Përkritazi me këtë, jam i kënaqur që kam fituar mbështetje të fuqishme nga Këshilli i Sigurimit përsa i përket strategjisë për të ecur përpara. Kjo do të thotë se ka shpresa të mëdha sa i përket aftësisë së Kosovës për të shënuar përparim të vërtetë lidhur me standardet dhe mundësimin e vlerësimit pozitiv të këtyre arritjeve në mesin e vitit 2005 dhe procesin që do të zhvillohet më pas drejt bisedimeve për statusin. Tani kjo varet prej jush, dhe ju duhet të tregoni rezultate.

Për këtë arsye, UNMIK-u tash është i gatshëm që t'ju mbështesë dhe është me rëndësi që Kuvendi dhe Qeveria të fillojnë të punojnë menjëherë.

Siç e dini, zbatimi i standardeve duhet të jetë prioritet për ju gjatë muajve të ardhshëm, në mënyrë që të sigurohet përparim i duhur para se të bëhet vlerësimi i vitit 2005.

Kuvendi do të luajë një rol kyç në miratimin e ligjeve, që është vitale për realizimin e standardeve.

Mirëpo, është po aq me rëndësi që procesi legjislativ të realizohet në mënyrë të hapur - demokratike dhe të përgjegjshme, në përputhje të plotë me Kornizën Kushtetuese. Edhe ky është standard. Kuvendi më parë ka mbajtur seanca të hapura për t'u konsultuar me ekspertë vendës dhe me pjesëtarë të opinionit për legjislacionet dhe çështje të interesit të përgjithshëm. Dhe, unë ju inkurajoj që të vazhdoni me këtë traditë.

Institucionet e përkohshme duhet të jenë në kontakt dhe të kenë mundësi të këmbëjnë qëndrime me opinionin e gjerë e të dëgjojnë hallet e tyre dhe të veprojnë pastaj në bazë të tyre. Standardet kërkojnë që t'i kenë parasysh shqetësimet dhe opinionet e të gjitha komuniteteve të Kosovës. Për shumë arsye, pjesëmarrja serbe në zgjedhje ka qenë e ulët, mirëpo ende ka vend për pjesëmarrje të tyre aktive në Presidencë, në Kryesi të Kuvendit apo komisionet gjegjëse.

Është përgjegjësi e secilit deputet, jo vetëm e komisioneve edhe organeve të dizejuara në mënyrë specifike, për t'i marrë parasysh interesat e komuniteteve, por është përgjegjësi edhe e të gjithë juve që ta bëni Kosovën një vend më të mirë për të gjithë qytetarët që jetojnë në të.

Siç e dini, UNMIK-u planifikon që t'i transferojë të gjitha kompetencat, jo ato që ndërlidhen me sovranitetin e drejtpërdrejt, ato kompetenca do t'i transferojë tek institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes sa më shpejt që është e mundur.

Themelimi i paradokohshëm i tri ministrive të reja, ajo për kthim dhe



komunitete, energjetikë e miniera dhe qeverisje lokale do të shoqërohen me ministri të reja, e veçanërisht në fushën e ekonomisë, e ndoshta më pas edhe në fushën e drejtësisë dhe sigurimit.

UNMIK-u dhe institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes duhet të kenë një qasje të përbashkët në përcaktimin e strategjisë më të mirë për transferimin apo bartjen e kompetencave. Mirëpo, bartja e kompetencave ka kuptim vetëm nëse shpie drejt veprimeve produktive dhe pozitive.

Kompetencat shtesë nënkuptojnë përgjegjësi më të madhe dhe veçanërisht kur bëhet fjalë për përparimin drejt realizimit apo implementimit të standardeve.

Unë, jam i gatshëm që t'i vërrë në dispozicionin tim të gjitha mekanizmat dhe masat për përforicimin dhe për fuqizimin e institucioneve të përkohshme. Këto mekanizma përfshijnë - mjetet e monitorimit dhe mbikëqyrjes, mirëpo edhe sanksioneve.

Jam i gatshëm që t'i sfidoj zyrtarët, të cilët dështojnë në realizimin e përgjegjësisë dhe të cilët i bllokojnë përpjekjet për të bërë përmirësim në fushat kyçe, siç janë të drejtat e pakicave, liria e lëvizjes, kthimi i të zhvendosurve, ofrimi në baza të barabarta të shërbimeve, mediat përgjegjëse dhe siguria.

Unë pres mbështetjen e përhershme të institucioneve të përkohshme në zbatimin e kësaj politike dhe veprimeve. Po ashtu, jam i vetëdijshëm se transferimi i suksesshëm i kompetencave ka nevojë për ndërtimin e kapaciteteve shtesë në institucionet e përkohshme. Për këtë arsye, kam marrë nismën që të mobilizoj mbështetjen e donatorëve për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes. Dymbëdhjetë muajt e ardhshëm do të jenë jetësor në përcaktimin e ardhmërisë së Kosovës. Puna e Kuvendit - koalicionit qeveritar, si dhe opozita parlamentare do të përcaktojnë se a ka sukses Kosova apo jo. Dështimi, nuk është opcion. Vetëm puna e rëndë, veprimet e vërteta dhe përparimi me interes të

Kosovës do të merren parasysh, tha Petersen.

## Procedura e zgjedhjes

Në vijim filloi procedura e zgjedhjes së kryetarit të Kuvendit dhe të Kryesisë së Kuvendit. Kryetarët e partive propozuan anëtarët. Nga LDK-ja u propozuan **Nexhat Daci** dhe **Fatmir Sejdiu**, nga PDK-ja - **Ramë Buja** dhe **Xhavit Haliti**, nga AAK-ja - **Naim Maloku**, nga Ora - **Gazmend Muhaxheri**, nga komunitetet joshqiptare dhe joserbe **Xhezair Murati**, ndërsa nga partitë që përfaqësojnë komunitetin serb, mbetet të caktohet kandidati më vonë. **Veton Surroi** kërkoi nga Grupi Parlamentar i LDK-së që të rishikojë vendimin eventual për kryetar të Kuvendit duke përzgjedhur një person të ri. Zoti Daci, me punën e deritashme është dëshmuar si joefikas dhe përjashtues. Besojmë se brenda subjektit të LDK-së ka njerëz të cilët mund të jenë unifikues të Kuvendit të Kosovës, tha Surroi. Në vazhdim me shumicë votash u zgjodh Kryetari i Kuvendit, **Nexhat Daci** dhe anëtaërt e Kryesisë, ashtu si u propozuan.

Në vijim seancën filloi ta udhëheqë kryetari i Kuvendit, akademik **Nexhat Daci**. Kryeparlamentari Daci iu drejtua të pranishmëve me këto fjalë: "Në emër të Kryesisë së posazgjedhur dhe në emrin tim personal, ju falënderoj të gjithëve. Në veçanti falënderoj edhe ata që patën mendim tjetërfare, sepse kjo tregon që në Kosovë demokracia është në veprim".

Po ashtu, në emër të Kryesisë premtojmë bashkëpunim të sinqertë, profesional dhe njerëzor, sepse të gjithë jemi të vetëdijshëm, që institucionet e reja kanë sfida të rëndësishme, numerikisht të bollshme dhe se kërkojnë përkushtim serioz profesional dhe demokratik.

Pastaj u ftua përfaqësuesi i partisë që ka siguruar numrin më të madh të vendeve në Kuvend, pra i Lidhjes Demokratike e Kosovës, që të paraqesë edhe oficielisht në Parlament emrin e kandidatit për

kryetar të Kosovës. Z. Kolë Berisha, nënkryetar i LDK-së tha se ky subjekt politik për kryetar të Kosovës, në mandatin e ardhshëm, propozon doktor Ibrahim Rugovën, kryetar i deritashëm.

**Xhavit Haliti** theksoi se, meqenëse po i hyjmë një procedure të rregullt, është dashur që Kryesia e posazgjedhur të mbajë mbledhjen e saj, ta bëjë rendin e punës dhe të vendosë për mënyrën e procedimit për zgjedhjen e kryetarit të Kosovës dhe të institucioneve tjera.

Sipas Kornizës Kushtetuese, partia e cila ka më shumë se 25 deputetë ka të drejtë të ketë edhe kandidat tjetër dhe mendoj se, akoma pa e shpjeguar procedurën e mënyrës së zgjedhjes së kryetarit të Kosovës, nuk është mirë që të fillojmë kështu seancën, tha Haliti.

Kryeparlamentari Daci duke u ndërlidhur me diskutimin paraprak theksoi se procedura e zgjedhjes së kryetarit të Kosovës, do të jetë plotësisht konform Kornizës Kushtetuese dhe rregullave të punës. Do të thotë, do të respektohet në tërësi procedura e zgjedhjes së kryetarit të Kosovës. U njoftuan deputetët se zgjedhja e kryetarit të Kosovës do të bëhet me votim të fshehtë dhe se në dy votimet e para kërkohet shumica e dy të tretave të votave të deputetëve të Kuvendit, ndërsa në rrethin e tretë kërkohet shumica e votave të deputetëve që votojnë. Pra, të gjitha përgatitjet procedurale teknike janë kryer konform rregullativave dhe ne mund të procedojmë me punën, tha Daci.

**Xhavit Haliti** shprehu mendimin se meqenëse Partia Demokratike e Kosovës ka kandidatin e vet për president të Kosovës, nuk mund të futemi as në votim të fshehtë. Meqenëse ka kundërkandidat për president, duhet të bëjmë debat lidhur me zgjedhjen e presidentit të Kosovës.

**Emrush Xhemajli**, kryetar i LPK në vijim theksoi se ne jemi të vetëdijshëm se Lidhja Demokratike e Kosovës, sipas rezultateve të zgjedhjeve dhe marrëveshjeve me part-

nerët e koalicionit ka fituar të drejtën për të propozuar para nesh kandidatin për kryetar të Kosovës, por mendojmë se kandidatura e zotit Rugova, që u paraqit këtu nga zoti Kolë Berisha duhet të bjerë , për arsye se ai në veprimtarinë e tij nuk është treguar i përgjegjshëm para organeve që e zgjedhin, si në vitet e 90-ta para lufte, si gjatë lufte. Si pasojë, ai nuk përfaqësoi dhe nuk përfaqëson unitetin e popullit, siç e kërkon ky post.

Zotëri Rugova është paraqitur joserioz para përfaqësuesve ndërkombëtarë. Atyre iu kërkon njohjen formale të pavarësisë së Kosovës, në kohën kur edhe për mospunën e tij, vendit tonë nuk i është rregulluar dokumentacioni i pavarësisë.

Për arsye të cekura më lartë, unë do të votoj kundër, dhe ju ftoj edhe juve të votoni kundër, tha Emrush Xhemajli.

**Numan Baliqi** tha se nuk dëshiroj ta prish atmosferën dhe njëherit popullit të Kosovës ua uroj institucionet, të cilat çdoherë do ta kenë përkrahjen tonë. Edhe ne kemi luftuar, edhe unë kam luftuar e edhe mëtej do të luftojmë për këto institucione, por më duhet t'i theksoj disa parregullësi që i përkasin bashkësive tjera si: boshnjakëve , romëve , egjiptasve, hashkalinjëve etj. Ky është njëri prej standardeve z. kryesues dhe se pikërisht përmbushja e këtyre standardeve është detyrë e Qeverisë së ardhshme.

Mendoj te diskutimi i mëparshëm e ku u bë fjalë për Kryesinë, për anëtarë të së cilës u zgjodhen njerëzit pa u konsultuar fare përfaqësuesit e boshnjakëve. Më falni këtu flas për boshnjakët dhe PAD-in , por as ata të hashkalinjëve, romëve dhe goranëve. Pra nuk janë konsultuar së paku katër bashkësi dhe kjo është ajo që unë mund ta quaj mospërfillje, sjellje rreth e rrotull apo edhe diskriminim.

Vërejtja ime më konkrete drejtohet në propozimin për ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës. Unë nuk mund t'ia lejoj vetes të marrë pjesë në diçka që do të

na përqeshi e tërë Kosova- që për ministër të shëndetësisë e cila është para agonisë , në kolaps, për çka janë përgjegjëse pikërisht këto institucione, të emërohet njeriu mësues e që mund t'i përkasë vetëm sektorit të arsimit e jo Ministrisë së Shëndetësisë.

### **E kemi për obligim që mos t'i befasojmë miqtë me zgjidhje jokredibile**

**Hashim Thaçi** pasi uroi që në këtë mandat, ky Parlament të jetë Parlament i debatit, i alternativave, i debatit që do të përshpejtojë ndërtimin e rendit demokratik, të institucioneve shtetërore të Kosovës, tha se ai dhe Partia Demokratike e

Në vijim Thaçi vlerësoi se procesi zgjedhor u zhvillua sipas standardeve më të larta evropiane. Pjesëmarrja e qytetarëve të Kosovës ishte e njëjtë me nivelin e vendeve tjera të demokracive në tranzicion. Duke vlerësuar me vëmendje pjesëmarrjen aktive të grupeve etnike joserbe, përfaqësimit të tyre në institucionet e ardhshme - është i meritueshëm dhe shumë domethënës për të ardhmen e Kosovës. Abstenimi i serbëve, për qytetarët e Kosovës nuk e humb kuptimin multietnik të zgjedhjeve. Respektimi dhe mbrojtja e minoritarëve në Kosovë për Kosovën është një ndër faktorët kryesorë për suksesin tonë të ardhshëm dhe institucionet e reja të Kosovës.



Kosovës, institucionet dhe qytetarët e Kosovës ndihen të hendikepuar që në ulëset e Parlamentit të Kosovës nuk është i ulur shefi i Grupit Parlamentar të PDK-ës, Fatmir Limaj. Ne çmojmë lart punën dhe angazhimet e zotit Limaj për ndërtimin e institucioneve demokratike. Çmojmë lart bashkëpunimin e tij me autoritetet e drejtësisë ndërkombëtare, ndërsa populli i Kosovës dhe institucionet besojnë plotësisht në pafajësinë e tij. Zoti Limaj do të duhej t'i kthehej familjes së tij dhe institucioneve të Kosovës, ku edhe e ka vendin. Besojmë se kjo do të ndodhë.

Më herët kisha propozuar projektin për afatizimin e zgjidhjes së statusit politik dhe ndërtimin e unitetit qeverisës për shtetin e Kosovës. Koha që kisha propozuar unë dhe Partia Demokratike e Kosovës ishte pranvera 2005, e që do të duhej të ishte fundi i fillimit të zgjidhjes së statusit politik. Logjika e refuzimit të ideve politike e tjera bënte që të ndodhin keqkuptime, ndodhi vazhdimi i statuskuos - i dhembshëm për Kosovën dhe qytetarët e saj. Koha, realiteti dhe bota perëndimore, na dha të drejtë, me gjasë - statusi do të fillojë të zgjidhet kah mesi i vitit 2005. Por, edhe kjo varet nga shumë faktorë.

Parimisht, Partia Demokratike e Kosovës dhe unë - si lider i kësaj qendre politikëbërëse në Kosovë, jemi përcaktuar në favor të ndërtimit të institucioneve me bazë të gjerë politike, përfaqësim të partive kryesore politike shqiptare dhe përfaqësim shumëetnik. Ky solucion qeverisës do të ishte solid dhe adekuat për aktualitetin dhe perspektivën trivjeçare kosovare.

Prej sot, Kosova, në kuptimin politik, qytetar dhe në raport me komunitetin ndërkombëtar - duhet të ketë një fillim të ri. Fillimi i mbarë do të nënkuptonte vetëvetiu vazhdim të suksesshëm të procesit, ndërsa fillimi i paqartë - pas pak kohe: paraqitje të krizës institucionale, politike, sociale e të sigurisë.

Është me interes që komuniteti ndërkombëtar po përcjell nga afër ndërtimin e institucioneve, por është edhe me rëndësi që ndërkombëtarët të respektojnë të drejtën e kosovarëve që ata vetë të zgjedhin mundësinë më të mirë të qeverisjes demokratike dhe bartësit e institucioneve. Këtë ata edhe e bëjnë, dhe iu jemi mirënjohës.

Ndërsa, ne vendësit kemi për obligim që mos t' i befasojmë miqtë me zgjidhje jokredibile, frikësuese e jokooperuese për dhe me mekanizmat ndërkombëtarë.

Uroj që të kuptohet drejt oferta e singertë për ndërtim të institucioneve me bazë të gjerë përfaqësuese për realizimin e interesave madhore të vendit dhe qytetarëve. Kjo formulë do të ndikonte edhe më tepër në relaksim të raporteve qytetare, punën më të mirë të institucioneve dhe natyrisht edhe në ngadhënjimin e demokracisë qytetare, por edhe përmirësimin e raporteve ndëretnike. Kjo formulë politike, Kosovës do t' i jepte kuptimin e vendit më stabil, me institucione më kompetente, me siguri më të madhe për bashkimin e Mitrovicës, për deenklavizimin e Kosovës, për thellimin e reformave të pushtetit lokal, për zbardhjen e fatit të të zhdukurve, për Trupat Mbrojtëse dhe Shërbimin Policor më me autoritet, vendosmëri më të madhe për luftimin e korrupsionit

dhe krimin të organizuar. Kjo do të përshpejtonte përmirësimin e gjendjes sociale të qytetarëve, sepse, për fat të keq, ne vazhdojmë të mbetemi vendi më i pazhvilluar dhe me numrin më të madh të të papunëve në Evropë. Kjo do të ndikonte në hapjen e vendeve të reja të punës; interesim më të madh për qytetarët tanë në diasporë. Kjo formulë për ndërtimin e institucioneve do t' i sillte imazh më të mirë vendit, do t' i evitonte lajmet e këqia për Qeverinë e re në mediat prestigjioze botërore, do të garantonte bashkëpunim më të mirë me qendrat vendosëse të politikës ndërkombëtare, përfaqësim të merituar në Bruksel, Nju-Jork e gjetiu, bashkëpunim më të mirë me fqinjët e Kosovës, më tepër siguri për investitorët e huaj, implementim më të shpejtë e të sigurt të kriterëve politike, ekonomike dhe legjislativë, si parafazë për zgjidhjen e drejtë të statusit politik. Por, mbi të gjitha, do të sillte unitetin kombëtar, politik e qytetar të domosdoshëm për periudhën nëpër të cilën po kalojmë si vend dhe popull.

Kjo zgjidhje, do t' u hapte perspektivë për sukses, do të kthente shpresën, optimizmin dhe besimin tek qytetarët se më në fund po fillon zgjidhja reale e problemeve të tyre për një jetë më të sigurt e më të mirë në Kosovën e re.

Ndokush mund të thotë se Kosovës i duhet opozita. Pajtohemi plotësisht. Por, sot, mbi të gjitha, vendit e qytetarëve i duhet sukcesi. E sukcesi arrihet jo me logjikë përjashtuese, diferencuese e përçarëse, por me qeverisje të unitetit, për shtetin e pavarur - sovran e të integruar të Kosovës në strukturat Veriatlantike.

Veprimet eksperimentale për ndërtimin e institucioneve nuk janë shpresë për sukses. Përkundrazi, hapin dilema të reja. Nuk janë shpresë, as për të mirën e qytetarëve, as për angazhimet e komunitetit ndërkombëtar në Kosovë. Kosovës së re i duhen institucionet e reja që punojnë për integrim e assesi që e izolojnë Kosovën. Duhet kuptuar se egoja e madhe për pushtet mund të shtyjë bërjen e

shtetit të Kosovës dhe ndërtimit të rendit demokratik. Përvojat e të tjerëve tregojnë se vendet e ndryshme, në momente kyçe e të vështira, për interesa madhore - kanë arritur konsensusin nacional dhe kanë pasur sukses. Partia Demokratike e Kosovës do të jetë opozitë reale e ofertës dhe e alternativave. Megjithë logjikën diferencuese të pozitës, ne do të punojmë që t' i gjejmë pikat e bashkëpunimit e jo të konfrontimit. Ne, në Partinë Demokratike të Kosovës, do të investojmë të gjithë potencialin kombëtar, politik dhe intelektual për qeverisjen e mirë të Kosovës, për ndërtimin e shtetit të Kosovës dhe promovimin e demokracisë qytetare, tha Hashim Thaçi.

### **Eshtë arritur marrëveshja për koalicionin qeverisës**

Pastaj fjalën e mori kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, **Ramush Haradinaj**, i cili tha se ne të gjithë jetojmë në Kosovë dhe po ashtu ne të gjithë e dimë se çfarë po bëjmë në institucione dhe çfarë po bëjnë partitë politike.

Mendova se është me dobi t' ju shpjegoj se në bazë të rezultatit të zgjedhjeve dhe të vendimit të partive demokratike të Kosovës që kanë marrë pjesë në zgjedhje, është arritur një marrëveshje për koalicionin qeverisës. Përpos zgjedhjeve të suksesshme, marrëveshja është arritur krejtësisht nga vendësit, që mendoj se është edhe një hap më tej që të dëshmojmë vetëbesimin tonë. Marrëveshja kishte edhe pjesë që shpjegonte mënyrën e votimit. Me qëllim që të respektojmë procedurat në Kuvend dhe të dëshmojmë përkushtimin tonë për seriozitet në punë, ne kemi arritur në momente në seancën e Parlamentit se kur do të vazhdojmë me rendin e ditës. Ajo që do të thosha me këtë rast është se të gjitha opinionet që i kemi veç e veç dhe të gjitha qëndrimet që i kemi veç e veç do të kemi ditë dhe momente kur do t' i bashkojmë për Kosovën, ndërsa po ashtu nuk do të ndalemi në përcaktimin për të qeverisë me



Kosovën në shërbim të të gjithë qytetarëve, jo vetëm të atyre që na kanë dhënë besimin, pohoi Haradinaj.

**Slavisha Petkoviç**, theksoi se nëse flasim për proceset demokratike në Kosovë, të njëjtat nuk mund t'i zbatoni kur ju mungojnë 250.000 mijë banorë të Kosovës në këtë rast serbë, të cilët për 5 vjet e gjysmë janë të zhvendosur jashtë vatrave të veta. Nëse kësaj i thonë demokraci, atëherë në këtë s'po e kuptojmë aq mirë.

Unë shpresoj që kur z. Haradinaj të bëhet kryeministër, në ekspozitë e tij për Programin e Qeverisë, do të ketë një vend edhe për këtë, të shohim se në çfarë mënyre këta njerëz mund të kthehen në shtëpitë e veta.

Unë pajtohem me zotin Thaçi se në Kosovë nuk duhet krijuar enklava, por gjithashtu nuk kam dëgjuar se kush do t'u garantojë siguri banorëve të Kosovës... Prapë them, meqë përfaqësoj Bashkësinë serbe, së pari më intereson për sigurinë e serbëve, pastaj edhe për sigurinë e të gjithëve, d.m.th. të të gjitha bashkësive në Kosovë. Përbërja e kaluar e Parlamentit për këtë çështje s' ka bërë asgjë absolutisht asgjë. Unë shpresoj, në të vërtetë dua të shpresoj se kjo përbërje e Parlamentit dhe Qeveria e re që do të formohet, duhet të tregojnë vullnet e atëherë mund të thuhet se kush do të jetë përgjegjës nëse 250.000 njerëz, prapë e them në këtë rast serbë, nuk kthehen atje prej ku kanë shkuar; nëse shtëpitë e tyre, pasuria e tyre nuk kthehen në gjendjen e mëparshme; nëse nuk kthehet pasuria e uzurpuar, toka e uzurpuar, firmat e kështu me radhë.

Unë mendoj se pa këto, nëse këto nuk mund t'i kemi, prej demokracisë s' do të kemi as "d"-në. Do të thotë se unë kushtimisht dua të punoj në interes të bashkësisë sime. Kjo është normale, dua të bashkëpunoj, s'kam ardhur këtu që dikujt t'i bëjë obstrukcion. Por gjithashtu, po them gjithashtu nuk do të lejoj që në programin e ardhshëm të Qeverisë të mos ekzistoj kjo çështje, pra të shi-

het se për çka kjo Qeveri është përgjegjëse e për çka jo, për vet faktin se Qeveria e mëparshme këto çështje nuk i ka pasur qartë të theksuara. S'ka qenë përgjegjëse për asgjë për shkak se i tërë Kuvendi ka qenë anëtarë i Qeverisë. Mua më vjen mirë sikur ky Kuvend tani do të ketë opozitë e cila, prapë po e them, do të jetë mirë po të ishte konstruktive për të filluar zgjidhjen e problemeve, për shkak se unë nuk po e shoh se si ju mendoni të fillohet me standardet, kur, e ritheksoj sërish, se Kosovës i mungojnë 250.000 banorë, prapë e them - rastin e serbëve.

**Veton Surroi** tha se zgjedhja e kryetarit të Kosovës është një privilegj që na jepet sot dhe është një rrjedhë e një procesi demokratik, i cili mund të quhet shembullor në tërë rajonin. Unë përgëzoj Lidhjen Demokratike dhe zotin Rugova për kandidimin e tij në këtë post. Po ashtu do të përgëzoja PDK-n për kandidimin e tyre, ndonëse ende s'e kemi dëgjuar emrin e kandidatit, por në çdo rast e përgëzoj procedurën e kandidimit si të tillë.

Duke pasur rëndësinë e këtij kandidimi, duhet të elaboroj shkurtimisht një kërkesë të thjeshtë. Ajo është që kandidatët për kryetar të na paraqesin vizionin e punës së tyre të ardhshme trevjeçare; që kandidatët të na bindin se puna e tyre do të jetë e drejtuar në përmbushjen e obligimeve të Kornizës Kushtetuese, të cilën fundi i fundit këto subjekte e miratuan dhe nënshkruan.

Në këto qëndrime, jo vetëm deputetët e Parlamentit të Kosovës, por edhe populli i cili e përcjell këtë debat, do të duhej të binden mbi ofertën e cila ekziston nga kandidati për kryetar dhe në aso rasti edhe neve deputetët të na e lehtësonte punën në votim.

Grupi Ora nuk ka ndërmend të pozicionohet anbllok, as në këtë e as në raste tjera. Nuk kemi ndërmend të votojmë për ose kundër vetëm pse jemi në opozitë. Dhe, për të arritur një cilësi të re të komunikimit mes pushtetit dhe opozitës, do të kërkonim që të hyjmë në procedurë ofertuese nga ana e kandidatëve për

kryetar. Në vijim kryeparlamentari Daci njoftoi të pranishmit se me qëllim të procedimit me votim të fshehtë për zgjedhjen e kryetarit të Kosovës, Sekretaria e Kuvendit, me mbështetje profesionale të OSB-esë ka bërë përgatitjet administrative dhe teknike, duke siguruar Komisionin votues prej tre zyrtarëve të Departamentit ligjor; regjistrin e deputetëve të pranishëm për votim; fletëvotimet; kutinë e votimit dhe vendvotimin. Ndërsa, subjektet politike mund të caktojnë nga një deputet për të vëzhguar - monitoruar procesin e votimit dhe të numërimit. Prandaj, do të shkojë çdo gjë konform Kushtetutës dhe procedurave.

## Dy kandidatë për President

**Jakup Krasniqi** njoftoi se Partia Demokratike e Kosovës shfrytëzon të drejtën e saj për të propozuar kundërkandidatin për postin e presidentit të Kosovës. Kjo bëhet, si tha ai, për t'i dhënë kuptim zgjedhjes së presidentit dhe demokracisë. Jemi të bindur se Kosova po hyn në procese të ndërlikuara politike, andaj nga presidenti i Kosovës kërkohet vendosmëri, energji pozitive, kthjelltësi politike dhe intelektuale, kualitete të larta morale dhe kombëtare.

Kandidati ynë është njeri me veprimtari të gjatë politike dhe atdhetare që nga mosha e tij e re. Ka qenë veprimtar i dalluar i aktivitetit ilegal atdhetar, i burgosur politik, pjesëtar aktiv i rezistencës aktive paqësore, si dhe i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe anëtar i Shtabit të përgjithshëm të UÇK-së. Në asnjë kohë të jetës së tij nuk i është nënshtruar a gjuhëzuar udhëheqësve shtetërorë të okupatorit e as udhëheqësit kriminel të luftës dhe të njerëzimit - Slobodan Milosheviqit, njeriut që i hapi shumë plagë dhe vështirësi Kosovës.

Kandidati ynë nuk është kandidat i përfolur në gazetari dhe publicistikë, nuk posedon pasuri të padeklaruar a të uzurpuar dhe, në kuptimin më të mirë të fjalës - është personalitet unifikues në jetën politike institucionale, ashtu siç i duhet Kosovës sot.

Kandidati ynë do të respektojë rendin dhe ligjin. Nuk do të mirret me simbolikat e kota dhe veprimet tjera të paligjshme, nuk do të luajë me simbole kombëtare, nuk do të partizojë në ekstrem administratën e presidentit, nuk do të shpërndajë deklarata a çmime tjera të paverifikuara për njerëz me apo pa biografi. Administrata e presidentit duhet të jetë pasqyrë e realitetit të Kosovës dhe pasqyrë e unitetit të saj. Kandidati ynë, gjatë gjithë aktivitetit të tij politik, veprimtarisë së tij politike, para dhe pas luftës çlirimtare, nuk ka nxjerrë në plan të parë pasurimin individual për ndërtim të ndonjë pallati luksoz, siç kanë bërë shumë bashkohanikë të tij pas luftës çlirimtare apo drejtues tjerë të institucioneve më të larta të Kosovës.

Kandidati ynë është personalitet me biografi të pastër si loti, ngado që ta marrësh.

Prandaj, Kosovës, në këtë kohë pa status politik të definuar, i duhet një personalitet me kualitetet që i posedon zotëri Ramë Buja, nga Bujani i Lypjanit.

Ramë Buja, ka të kryer fakultetin filozofik - gjuhën dhe letërsinë shqipe, fakultetin ekonomik dhe është magjistër i shkencave juridike. Gjatë viteve të 80-ta është marrë me veprimtari politike atdhetare ilegale, ka qenë i burgosur politik, veprimtar aktiv në vitet e rezistencës paqësore aktive dhe pjesëtar i Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës, anëtar i Shtabit të përgjithshëm të saj, anëtar i Delegacionit të Kosovës në Rambuje, ministër i pushtetit lokal në Qeverinë e përkohshme dhe tani deputet në Kuvendin e Kosovës.

Është në nderin tuaj dhe të Kosovës që votën tuaj ta jepni për kandidatin tonë për president të Kosovës, zotëri Ramë Buja. Është momenti i duhur që Kosova ta ketë një kandidat që bashkon popullin shqiptar dhe gjithë qytetarët e Kosovës. Është njeri që detyrave iu qaset me përgjegjësi dhe përkushtim dhe zgjedhja e tij president i Kosovës do t'ju nderojë ju dhe të gjithë qytetarët e Kosovës.

Në vijim Nexhat Daci bëri të ditur se do të rregullohet lista dhe do të futen

të dy kandidatët për president : nën një kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe nën dy kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës. Pastaj filloi procesi i votimit . Në dy rrathët e parë të votimit asnjëri kandidat nuk fitoi shumicën e duhur të votave për t' u zgjedhur president. Në ndërkohë, Partia Demokratike tërhoqi kandidatin e saj nga procesi i mëtejshmë i votimit. Në rrethin e tretë për dr. Ibrahim Rugovën votuan 64 deputetë, ndërsa 32 ishin kundër. Kështu, dr. Ibrahim Rugova u zgjedh president i Kosovës.

Në vijim **dr. Ibrahim Rugova** iu drejtua të pranishmëve me këto fjalë: "I nderuari kryetar Daci, deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës, Ju falënderoj për besimin e dhënë që edhe në mandatin e ardhëm të udhëheq vendin tonë të dashur Kosovën, në cilësinë e presidentit.

Të nderuar deputetë, Beto hem solemnisht se do ta ruaj e mbroj integritetin territorial të vendit tonë - Kosovës dhe unitetin e popullit, do të angazhohem për zhvillimin ekonomik dhe demokratik, për stabilitetin, prosperitetin dhe mirëqenien e të gjithë qytetarëve, do të punoj për njohjen sa më të shpejtë të pavarësisë dhe të integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian e në NATO, si dhe për forcimin e miqësisë permanente me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Zonja dhe zotërinj, Më lejoni që nga kjo Seancë përuruese solemne të Kuvendit të Kosovës të përshëndes Presidentin Bush, Kryeministrin Bler, Presidentin Shirak, Kancelarin Shroder, Kryeministrin Berlusconi dhe Sekretarin gjeneral Anan që po e përkrahin Kosovën.

Si gjithmonë, përshëndetje të ngrohita i dërgoj atit të shenjt Papa Gjon Palit II, që gjithmonë kujdeset për Kosovën.

Zoti ju bekoftë! Zoti e bekoftë Kosovën!"

Kryeparlamentari, pastaj, në bazë të marrëveshjes së partive partnere në koalicion, si dhe në pajtim me Kreun 9.3.8 dhe 9.3.9 të Kornizës

Kushtetuese, ftoi kryetarin e Kosovës, zotin Rugova që ta bëjë propozimin e kandidatit për kryeministër të Kosovës.

Presidenti Rugova shpalli vendimin : "Në bazë të komptencave kushtetuese dhe në bazë të marrëveshjes së koalicionit në mes të LDK-së, AAK-së dhe partnerëve tjerë të koalicionit, kam vendosur ta nominoj zotëri Ramush Haradinaj për Kryeministër të Qeverisë së Kosovës. Njëherësh kam kërkuar nga kryeministri i nominuar që ta formojë Qeverinë në bazë të marrëveshjes së koalicionit".

Pastaj kandidati i propozuar për Kryeministër të Kosovës, zotëri Haradinaj paraqiti listën e ministrave të propozuar.

Në bazë të marrëveshjes së koalicionit dhe të kërkesës nga nominimi, tha Haradinaj, kam marrë përsipër ta bëj kompletimin e Qeverisë së Kosovës me ministrat, si vijon:

- **Zëvendëskryeministër** - Adem Salihaj
- **Ministër të Ekonomisë dhe Financave** - Haki Shatri, me profesion ekonomist;
- **Ministër i Shërbimeve Publike** - Melihate Tërmkollli, me profesion juriste;
- **Ministër i pushtetit Lokal** - Lutfi Haziri, me profesion drejtimi i shkencave matematiko-natyrore;
- **Ministër i Transportit dhe Telekomunikacionit** - Qemajl Ahmeti, me profesion inxhinier i elektroteknikës;
- **Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë** - Agim Veliu, me profesion jurist;
- **Ministër i Kulturës** - Astrit Haraçia, jurist;
- **Ministër i Mbrojtjes së Ambientit dhe të Planifikimit Hapësinor** - Bajram Kosumi, me profesion magjistër i letërsisë shqipe;
- **Ministër i Energjetikës dhe Minierave** - Ethem Çeku, me profesion magjistër i historisë;
- **Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale** - Ahmet Isufi, profesioni gjuhë dhe letërsi;
- **Ministër i Industrisë dhe Tregtisë**



- Bujar Dugolli, me profesion historian - magjistër;

- **Ministër i Shëndetësisë** - Sadik Idrizi, filolog.

Po ashtu, më lejoni ta informoj Parlamentin se dy ministri janë paraparë të udhëhiqen nga serbët e Kosovës. Meqenëse ministrat ende nuk janë nominuar, ne kemi paraparë emërimin e zëvendësve dhe në një seancë të radhës, Parlamenti do të ketë mundësinë po ashtu të njihet me zëvendësit tjerë.

Në bazë të obligimit, unë kam para vetes edhe Programin e Qeverisë së Kosovës si propozim. Po ashtu, kam edhe një ekspozitë lidhur me Programin, të përgatitur me këtë rast, ndaj në bazë të procedurës unë do t'i përgjigjem kërkesës suaj.

Pastaj filloi procesi i votimit. Për zgjedhjen e kryeministrit dhe të kabinetit të qeverisë nga deputetët e pranishëm 72 ishin për, 2 deputetë votuan kundër, ndërsa 5 të tjerë abstenuan.

### **Shqetësim për fatin e procesit politik ...**

Në vijim mori fjalën shefi i Grupit parlamentar të PDK-së, **Jakup Krasniqi**, i cili tha se ne, demokratët e Kosovës, me vëmendje të shtuar kemi përcjellë sidomos përbërjen e kabinetit të Qeverisë së re të Kosovës. Edhe pse kemi qenë për një koalicion më të gjerë, që arsyetimin e dha kohë më parë kryetari ynë, ne si Parti politike kemi pranuar të jemi të gatshëm për një opozitë dhe opozitë e fuqishme për avancimin e procesit politik, por nuk do të hezitohet të denoncojmë çdo paligjisi, paaftësi, fudullëk të institucioneve në përgjithësi, e të Qeverisë - në veçanti, që mund të ndodhin.

Ju, koalicionin qeverisës e keni bërë për interesa tuaja klanore. Nuk keni pasur parasysh pozicionin e Kosovës - pa statusin shtet të pavarur të Kosovës. Nuk keni patur parasysh stabilitetin politik, ekonomik, sigurinë dhe problemet e ndryshme sociale - për çka keni marrë një përgjegjësi të madhe.

Ne kuptojmë interesin tuaj, prandaj kërkojmë nga ju që të kuptoni drejt

rolin e opozitës dhe kërkesat tona opozitare. Ju e dini se ne jemi mësuar të jemi kujdestar të padrejtësive dhe të paligjësive saherë që ka ndodh kjo në Kosovë.

Detyra jonë është të jemi kujdestar për t'i fokusuar gabimet tuaja të djeshme, të sotme dhe të ardhshme. Problemeve dhe interesave të Kosovës do t'i qasemi me përkushtim, profesionalizëm e vendosmëri. Do të denoncojmë çdo shkelje ligjore e financiare, çdo gabim politik e paaftësi në qeverisje.

Ne i kuptojmë vështirësitë profesionale e politike të Kryeministrit të ri. E kuptojmë presionin dhe denoncimet që i janë bërë që sa vite nga kundërshtarët e tij politik - tani aleat, si dhe presionin e padrejtë që bën Tribunali i Hagës - dhe jo vetëm atij - në bashkërendim me strukturat e vjetra e të reja serbe, por kjo nuk na pengon t'i shfaqim rezervat tona për kabinetin e tij. E kuptojmë se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk ka mund të ofrojë një ekip tjetër më profesional; ka ofruar fytyrat e saj politike që së paku nuk janë figura të panjohura politike, por nuk mund të kuptojmë aleatin e saj të koalicionit - LDK-ën - të cilës nuk i mungojnë kuadrot e kualifikuara, intelektualët e profesionistët, për të cilët ka folur shumë gjatë fushatës zgjedhore. Ku iu avulluan intelektualët dhe profesionistët e shumtë? Pse del kaq e varfër me intelektual e profesionist? Ajo jo vetëm që ka ofruar kuadër të pakualifikuar, mendoj në përjashtim të parëndësishëm, por ka ofruar kuadro që janë shquar në këtë qeverisje lokale, ka ofruar kuadro që kanë qenë konfliktuoz, të paaftë dhe keqpërdorues të pozitave që kanë mbajtur nëpër komuna prej nga ata vijnë.

Viti 2005 - ka kohë që është pritur të jetë viti i një kthese të madhe, i ndryshimeve të mëdha, viti i energjive dhe i përgjegjësive të mëdha.

Unë ju pyes sinqerisht, zonja e zotrinj deputetë, Qeveria e ofruar - a i posedon kualitetet profesionale, politike dhe intelektuale që i duhen Kosovës sot? Unë nuk kërkoj përgjigje nga ju. Përgjigjuni ndërgjegjes suaj në raport

me proceset që kemi përpara. Mendoni edhe për të ardhmen e fëmijëve tuaj.

Për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, në emër të të cilës po flas, nuk paragjykoj, por po flas për shqetësimet tona pasi që ne jemi më shumë se të shqetësuar për fatin e procesit politik, për fatin e zhvillimit ekonomik, për sigurinë dhe drejtësinë, për të ardhmen e fëmijëve tanë.

Këta njerëz, nuk i kanë kualitetet morale, politike, intelektuale, profesionale e as atdhetare për të qeverisur me Kosovën, me status të padefinuar politik. Kemi frikën se këta njerëz janë zgjedhur nga grupe joformale për ta kriminalizuar jetën politike dhe ekonomike në tri vitet e ardhshme në Kosovë. Kemi frikë se ky formacion qeverisës do ta izolojë edhe më shumë Kosovën edhe ashtu të copëtuar dhe të izoluar. Këtij formacioni qeverisës nuk ia kemi besën se do t'i relaksojë as marrëdhëniet njerëzore në Kosovë. Kur e them këtë, kemi parasysh raportet tepër të çrregulluara që sjellin këta kandidatë nga komunat prej të cilave vijnë.

Dëshira ime është që në tri vitet e ardhshme të ndodhë e kundërta e kësaj që po e them sot në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, por problemet e Kosovës nuk zgjidhen vetëm me vullnet e dëshira të mira. Problemi i Kosovës nuk është problem formal.

Partia Demokratike e Kosovës ka respekt të madh për rolin e familjes Haradinaj në luftën çlirimtare, për flijimet e saj për Kosovën, por ne - për hirë të Kosovës - jemi të detyruar të mos e votojmë Qeverinë e Ramushit. Duke u ndërlidhur me diskutimin e Krasniqit, kryeparlamentari Daci tha: " Zoti Krasniqi, sot keni thënë ç'keni dashur. Keni denoncuar, keni përdorur çdo fjalor të mundshëm. Dhe, sot kemi provuar, ashtu siç e tha edhe kryetari juaj - ta kemi demokracinë e plotë në veprim. Edhe unë po ju premtoj, në qoftë se e vazhdoni kështu, e unë i udhëheqi seancat - nuk do të ketë përsëritje të gjërave të këtilla".

## Ndihma amerikane për mbarëvajtje të proceseve zhvillimore në Kosovë është e një rëndësie të veçantë

*Miratimi i ligjeve, që do të jenë në funksion të përmbushjes së standardeve, ndër detyrat parësore të Parlamentit*

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, priti sot në një takim shefin e Zyrës Amerikane në Kosovë, Philip Goldberg. Pasi i uroi zgjedhjen në postin e kryeparlamentarit të Kosovës, z. Goldberg shprehu edhe përgëzimet për procedurën demokratike të konstituimit e të zgjedhjes së institucioneve më ta larta të Kosovës. Në qendër të vëmendjes së



bashkëbiseduesve ishin çështje të zhvillimit të Kosovës, me theks të veçantë në pozitën e realizimit të drejtave të minoriteteve, duke u angazhuar për lëvizje të lirë të qytetarëve. Këto detyra do të jenë edhe një ndër prioritetet kryesore për ekzekutivin e Kosovës. Kryeparlamentari Daci dhe z. Goldberg u pajtuan për rëndësinë që ka ndihma amerikane për mbarëvajtje të punëve e të mbarë proceseve zhvillimore në Kosovë, në kuadër të së cilës me vite të tëra u realizuan shume projekte të përbashkëta të lirisë dhe të demokracisë. Kjo përkrahje e ky bashkëpunim, shoqëruar edhe me një ndihme të

pakursyer të ekspertëve të lëmenjve përkatës, si edhe në të kaluarën, do të jetë i nevojshëm edhe në vijim, në rrugën e zhvillimeve të gjithmbarshme, për të përballuar të gjitha sfidat me të cilat ballafaqohen qytetarët tanë. Në këtë vështrim kërkohet përgjegjësi nga të gjitha institucionet e qytetarët në Kosovë, për të ecur sigurt drejt integriteteve evropatlantike. Ndërkaq, duke folur rreth punëve të ardhshme që presin Parlamentin e Kosovës, u tha se theksi duhet të vihet sidomos në miratimin e ligjeve që do të jenë në funksion të përmbushjes së standardeve.

## Shteti sloven të avokojë në rrugën e Kosovës drejt Bashkimit Evropian

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, ka pritur sot ministrin e Punëve të Jashtme të Sllovenisë, Dimitrij Rupel, i cili është edhe kryesues i radhës së OSBE-së dhe ka biseduar me të për zhvillimet në Kosovë, si dhe për mundësitë e gjera të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Sllovenisë.

Në këtë takim, në të cilin merrnin pjesë edhe shefi i OSBE-së në Kosovë, Paskal Fieski dhe bashkëpunëtorë të zotit Rupel, profesor Daci duke vlerësuar të arriturat e Sllovenisë në planin zhvillimit ekonomik, të demokracisë dhe të anëtarësimit në Unionin Evropian, ka shprehur konsideratat dhe besimin e qytetarëve të Kosovës në shtetin sloven dhe popullin e tij. Në këtë vështrim Daci ka kërkuar avokimin e shtetit sloven në rrugën e Kosovës drejt Bashkimit Evropian dhe është angazhuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Sllovenisë, sidomos në planin ekonomik, të teknologjisë dhe të investimeve.

Ministri i jashtëm sloven, Rupel, i ka vlerësuar të arriturat e Kosovës pas përfundimit të luftës dhe vullnetin e fortë të kosovarëve për liri, demokraci dhe përparim. Ai duke konstatuar mundësitë e gjera, sidomos për bashkëpunimin ekonomik, është zotuar se vendi i tij, edhe si kryesues i radhës së OSBE-së, do të angazhohet për mbarëvajtjen e punëve dhe përparimin gjithëpërfshirës të Kosovës.

## Udhëheqja e Kosovës do të plotësojë kriteret për statusin final të vendit

*Kosova nuk është dhe nuk do të jetë pjesë e Serbisë*

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, ka pritur sot shefin e Zyrës së Britanisë së Madhe në Kosovë, z. Mark Dickinson dhe ka biseduar me të për çështjet që e preokupojnë udhëheqjen e institucioneve të vendit. Në bisedë vëmendje e posaçme i është kushtuar agjendës së Kuvendit për përmbushjen e standardeve për Kosovën, për çështjen e reformimit të pushtetit lokal dhe të decentralizimit dhe përgjithësisht për plotësimin e kushteve për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Me këtë udhëheqje që ka, Kosova do të plotësojë kriteret për statusin final të vendit, është shprehur optimist kryeparlamentari Daci. Ai është shprehur edhe në favor të decentralizimit dhe është angazhuar që t' u jepet më shumë hapësirë minoriteteve. Do të ketë komuna ku ka nevojë, si Graçanica dhe minoriteti turk në rrethinat e Prizrenit, por edhe për komuna të reja në funksion të zhvillimit më të shpejtë ekonomik, si Hani i Elezit, bie fjala. Daci, ndërkaq, e ka vlerësuar të nevojshme involvimin edhe të opozitës në procesin e reformimit të pushtetit lokal.

Nga ana e tij shefi i Zyrës së Britanisë së Madhe në Kosovë, z. Mark Dickinson, demokratizimin e raporteve në Kosovë, bashkëpunimin me mekanizmat ndërkombëtarë dhe sidomos plotësimin e standardeve, e ka vlerësuar tepër të rëndësishme për ardhmërinë e vendit. Të dy bashkëbiseduesit, ndërkaq, janë pajtuar për rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë.

Duke e komentuar vizitën e presidentit serb Tadiq në Kosovë dhe deklaratat e tij në tubimet me qytetarët serbë, Daci është shprehur i prerë se Kosova nuk është dhe kurrë nuk do të jetë pjesë e Serbisë. Këtë madje e dinë, jo vetëm politikanët serbë, por edhe shumica e serbëve lokalë në Kosovë, është shprehur Daci, i cili deklaratat e pamatura të z. Tadiq i ka parë në funksion të luftës politike në Beograd. Megjithatë, Daci është shprehur se është mirë që Tadiq ka vizituar Kosovën. Udhëheqja e Kosovës angazhohet për raporte reciprociteti dhe mëton të realizojë vizita dhe komunikim të lirë me institucionet dhe me qytetarët e Luginës së Preshevës, të Maqedonisë e tj. Daci madje është shprehur i gatshëm që të takohet në mënyrë institucionale edhe me udhëheqësit e Serbisë, për të krijuar raporte normale me të gjitha vendet e rajonit.

Tadiqi u ka sjellë serbëve të Kosovës një pëlthurë flamuri, është shprehur figurativisht Daci, porse më mirë do të ishte t' u sillte ndihma materiale, siç ka vepruar Qeveria e Kosovës për popullsinë e Shqipërisë së Veriut, pas bllokimit të rajonit nga bora.

# Mbështetje pa hezitim për frymëmarrje të lirë të biznesit

*Institucionet e Kosovës veprojnë unike sa i përket ringjalljes ekonomike të vendit dhe plotësimit të standardeve. Biznesmenët kosovarë kërkojnë politika më të avancuara ekonomike, fiskale dhe doganore, legjislacion që garanton thithjen e investimeve të huaja dhe eliminimin e konkurrencës jolojale*

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, ka ftuar sot përfaqësuesit e biznesit kosovar në një këshillim me temën "Legjislacioni dhe biznesi në Kosovë", në të cilin merrnin pjesë kryeministri Ramush Haradinaj dhe ministrat Ethem Çeku e Bujar Dugolli.

Shekulli XXI do të jetë shekulli i globalizimit, jo vetëm ekonomik botëror, prandaj institucionet e Kosovës, të cilat në këtë mandat veprojnë në unitet të plotë veprues, mëtojnë që Kosovën ta sjellin në normalitet, u është drejtuar kryeparlamentari Daci përfaqësuesve të biznesit kosovar. Duke i falënderuar biznesmenët e Kosovës për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm për rimëkëmbjen e ekonomisë së vendit, edhe në koniuktura tepër të pavolitshme ekonomike, ai ka përkujtuar se Kosova ka arritur ta krijojë vetë buxhetin e vendit dhe ka arritur që pas zgjedhjeve të dyta parlamentare, vetë t'i krijojë institucionet qendrore. Ai, ndërkaq, ka shtuar se Kosova ende nuk e ka fituar të drejtën ta menaxhojë vetë buxhetin e saj, kurse vazhdohet me mekanizma të tillë paralel të Qeverisë, si Autoriteti Ekonomik Fiskal, në të cilin Kosova mëtohet të mbahet në minorancë.

Daci, duke i referuar një teoricienti të njohur të ekonomisë politike, është shprehur për prioritetet e shoqërisë në zhvillim: krijimin e një mjedisi të aftë që të absorbojë investimet private ekonomike dhe të mekanizmave të aftë që të menaxhojnë krizat sociale dhe ekonomike. Ai me këtë rast ka përkujtuar faktin që një e katërta e buxhetit të Kosovës shpenzohet në "blerjen e qetësisë sociale", kurse fonde të shumta akumulohen në konto jashtë vendit, të cilat nuk i kontribuojnë zhvillimit ekonomik të Kosovës, ka thënë Daci.

Kreu i legjislativit të Kosovës në

takim me biznesmenët ka shprehur rezervat e tij në fokusimin vetëm në ekonomi të vogël dhe të mesme. Ai, ka shprehur dyshim se me këtë koncept mund të aktivizohen resurset ekonomike të Kosovës, siç janë minierat dhe sistemet e mëdha ekonomike.

Kryeministri i Qeverisë së Kosovës, Ramush Haradinaj, duke iu drejtuar përfaqësuesve të biznesit ka theksuar se Kosova gradualisht po e zë hapin e zhvillimit dhe po e tejkalon prapambeturin e trashëguar nga rrethanat e pavolitshme historike dhe nga pasojat e luftës së fundit në Kosovë. Ka ardhur koha, ka theksuar Haradinaj, që Qeveria dhe institucionet tjera të Kosovës të luajnë një rol më aktiv në zhvillimin ekonomik dhe përkrahjen e ndërmarrjeve kosovare. Ai me këtë rast ka paralajmëruar krijimin e një Agjencioni për promovimin e investimeve të huaja dhe fillimin e negociatave me institucionet financiare ndërkombëtare për marrjen e kredive edhe para përcaktimit të statusit të Kosovës. Do të hulumtojmë mundësi të skemave të financimit të ndërmarrjeve të prodhimeve për eksport, zhbllokimin e privatizimit, zhbllokimin e fondeve nga asetet e ndërmarrjeve të privatizuara dhe angazhimin e këtyre mjeteve në zhvillimin ekonomik të vendit, ka premtuar kreu i Qeverisë së Kosovës.

Haradinaj është angazhuar për marrëdhënie të mira me shtetet e rajonit dhe për lidhjen e marrëveshjeve për tregti të lirë me këto vende, në interes të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Ismail Kastrati, ka përmendur një vistër të tërë të vështirësive të biznesit kosovar, duke theksuar sidomos shumëllojshmërinë e zbatimit të ligjeve në Kosovë. Ai ka vënë në spikamë sidomos rëndësinë e mënj-

nimit të taksave doganore për lëndën e parë që nuk prodhohet në Kosovë. Nëse heqim doganën në lëndë të parë dhe në investime kapitale, të ardhurat buxhetore të Kosovës do të fillojnë rriten që vitin tjetër, ka theksuar Kastrati. Ai, ndërkaq, ka kërkuar impelementimin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, nëpërmjet akteve nënligjore, duke përmendur edhe miratimin e një varg ligjesh sistimore ekonomike.

Përfaqësuesi i Bankës së Biznesit Privat, dr. Nazmi Mustafa, por edhe përfaqësues të tjerë të biznesit kanë vënë në pah domosdoshmërinë e harmonizimit të legjislacionit dhe të sistemit ekonomik. Nga shumica e folësve, ndërkaq, është kërkuar reformim i thellë i politikave ekonomike, me theks të veçantë asaj fiskale dhe doganore, kurse që të gjithë kanë kërkuar kushte të barabarta për biznes dhe eliminimin e konkurrencës jolojale. Biznismenët e Kosovës kanë theksuar se me këto kushte të rënda të kredive ekonomike, nuk ka gjasa për afarizëm të suksesshëm në Kosovë. Nga takimi gjithsesi ka rezultuar se në Kosovë, me gjithë kushtet e rënda të afarizmit, ka prodhim cilësor, madje edhe eksport në vendet Unionit Evropian dhe në vendet tejoqenaike. Për të qenë ironia e madhe, derisa prodhimet e Kosovës tregtohen (me të drejtë) pa doganë në vendet Unionit Evropian, prodhimet e atyre vendeve duhet të paguajnë doganën që të shitën në Kosovë, ndërkohë që vendin gjithandej e kanë vërsuar mallra të vendeve të tjera, të futura ilegalisht dhe me cilësi të dyshimtë.

Qëllimi i takimit, prandaj, ishte që të sheshohen rrugëzgjidhje për problemet ekonomike dhe të përvijohet vizioni për zhvillimin e përsheptuar të vendit. Fillim i mbarë që duhet të materializohet në vazhdimësi.



# Projektligj në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

*Me rastin e regjistrimit OJQ-të patjetër duhet të paraqesin raportet financiare, por edhe projektet e punës. Në këtë mënyrë ato do të shtonin nivelin e transparencës për punë e tyre*

**Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media, kryesuar nga Nekibe Kelmendi, kryetare,** organizoi sot një dëgjim publik përkitazi me Projektligjin për lirinë e asociimit në OJQ, i cili është përkrahur në parim nga ana e Kuvendit të Kosovës. Ky projektligj rregullon themelimin, regjistrimin, udhëheqjen e brendshme, veprimtarinë dhe shuarjen e personave juridikë të organizuar si OJQ. Duke hapur debatin, z. Nekibe Kelmendi theksoi se nga ana e Kuvendit ky projektligj është cilësuar si akt i hartuar me teknikë të përsosur, duke synuar që të disiplinojë OJQ-të në llogaridhënien financiare, ku deri tash nuk kishte ndonjë rregull. Deputetët kanë identifikuar edhe disa mangësi të këtij projektligji, që do të evito-



hen në vijim të përpunimit të tij. Pjesëmarrësit e këtij dëgjimi publik i dhanë përkrahje hartimit të këtij projektligji, duke vlerësuar se qysh moti na është dashur një ligj i këtillë, i cili do të ketë nën ombrellë OJQ-të. U theksua se projektligji është i një

rëndësie parësore për shoqërinë tonë që shpie drejt avancimit të nivelit të sigurimit të të drejtave themelore të njeriut. Ai është në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Me këtë rast u dhanë edhe disa vërejtje e sugjerime që kishin për qëllim begatimin e tekstit të këtij projektligji. Vëmendja e diskutuesve u përqendrua sidomos në nenet, përkatësisht pikat që kanë të bëjnë me regjistrimin dhe reregjistrimin, posaçërisht kur është fjala për afatet e kryerjes së këtyre procedurave. U tha se me rastin e regjistrimit OJQ-të patjetër duhet të paraqesin raportet financiare, por edhe projektet e punës. Në këtë mënyrë OJQ-të do të shtonin nivelin e transparencës për punën e tyre.

## Licencat të kenë afat më të gjatë

Projektligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, i cili tashmë është përkrahur në parim nga ana e Kuvendit të Kosovës, është i një rëndësie të veçantë për zhvillimet e ardhshme në Kosovë. Ai do të ndikojë në cilësinë e demokracisë së vendit. Me disa saktësime e përmirësime në procesin e amendamentimit, ai do të jetë në pajtueshmëri të plotë me standardet evropiane në këtë lëmë. Ky projektligj do të inkurajojë konkurrencën e ndershme në hapësirën mediale. Këto ishin disa nga konstatimet më thelbësore të dëgjimit të sotëm publik lidhur me Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave, organizuar nga Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media i Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga Nekibe Kelmendi, kryetare e Komisionit. Në këtë dëgjim publik merrnin pjesë edhe Robert Gillete, Komisioner i Përkohshëm i Mediave, përfaqësues të media elektronike e të shkruara të Kosovës, përfaqësuesi i OSBE-së etj. Përfaqësuesit e mediave përkrahën këtë projektligj, por ata dhanë mjaft vërejtje e propozime në tekstin e këtij projektligji. Shqetësim më të madh te përfaqësuesit e mediave kishte zgjuar çështja e mënyrës së zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të KPM-së, posaçërisht ajo se nga cilat subjekte do të vinin ata. Kishte propozime që këta anëtarë të mos zgjedhen nga radhët e partive politike. Të pranishmit ishin unanimë në propozimin që neni 20, pika tetë, e këtij projektligji të fshihet tërësisht nga teksti i projektligjit. Kjo pikë e këtij neni ka të bëjë me autorizimet, që i jepen drejtorit ekzekutiv, që në konsultim me Këshillin Drejtues, në situata emergjente, të shqiptojë masa për suspendimin e përkohshëm të licencave transmetuese. Debatit sipas përfaqësuesit të Asociacionit të Pavarur të Gazetarëve Profesionistë, përbënte një konsensus të mediave sa i përket këtij projektligji, Vëmendja e diskutuesve u përqendrua edhe në kohëzgjatjen e licencave, duke u dhënë propozime që afatet të jenë më të gjata në pikëpamje kohore.

## Ndërmarrjet e vogla e të mesme duhet të jenë forcë motorike e zhvillimit ekonomik të Kosovës

**Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energjetikë, transport dhe telekomunikacion i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga z. Fatmir Rexhepi-kryetar i Komisionit,** sot mbajti debat publik për Projektligjin për përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Gjatë diskutimit për këtë Projektligj, të gjithë të pranishmit u pajtuan se Kosovës i duhet një ligj që do të ndihmojë, gjegjësisht rregulloj marrëdhëniet në këtë lëmë, si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë funksional, për shkak se, siç u theksua edhe në diskutime, në zhvillimin e gjithmbarshëm të ekonomisë së Kosovës, ndërmarrjet e vogla e të mesme në këtë drejtim janë forcë e rëndësishme motorike. Në ekonomitë e shumë vendeve të botës, ekonomia e vogël dhe e mesme merr pjesë me 90 e më tepër për qind, prandaj këtu edhe shihet rëndësia e tyre. Është mirë që në këtë Projektligj qartas të definohet përkrahja financiare nga buxheti i Kosovës, (i cili këtë vit, për këto ndërmarrje, nuk ka paraparë ndihmesë financiare), mënyra e kreditimit të këtyre ndërmarrjeve, investimet e jashtme në këtë lëmë, krijimi i zonave të lira doganore, bashkëpunimi me strukturat lokale e qendrore etj.

Në këtë debat publik, edhe pse pati mendime se ky Projektligj nuk është përgatitur mirë nga hartuesi dhe se i njëjti duhet kthyer në ripërpunim, prapëseprapë në fund u vendos që vërejtjet dhe rekomandimet, në formën e shkruar, t'i dërgohen Komisionit i cili në mbledhjen e vet të rregullt do t'i shqyrtojë me kujdes, në mënyrë që ato të vlefshme t'i marrë si rekomandime të veta në këtë Projektligj.

# Ekonomia, shëndetësia, siguria dhe shteti ligjor meritojnë përkushtim të veçantë

1. Cili sipas jush duhet të jetë tehu kryesor i angazhimeve të deputetëve për këtë vit ?
2. Nga cilat fusha janë më të domosdoshme hartimi dhe aprovimi i ligjeve të reja, më saktësisht, cilat ligje do të ishin të dorës së parë për t' u aprovuar nga ana e Kuvendit të Kosovës?

## Naim Jerliu



1. Mendoj se gjatë këtij mandati, e në veçanti gjatë këtij viti, krahas veprimtarisë që ka të bëjë me shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve në Parlament, duke përfshirë edhe iniciativat ligjore, do të jetë shumë me rëndësi që brenda fushës së përgjegjësisë të ushtrohet autoriteti për të mbikëqyrur zbatimin e ligjeve nga Qeveria e Kosovës apo nga ministritë përkatëse. Në përputhje me këtë, nëpërmjet komisioneve do të duhej të kryhej kontrolli për efektivitetin e ligjeve në fuqi, për zbatimin e tyre si dhe për veprimtarinë e përgjithshme të ministrive përkatëse. Mendoj se ky anagazhim do të duhej të jetë një preokupim parësor tashmë, kur kemi të miratuara dhe pritet të miratojmë një varg ligjesh, si dhe kur na pret vlerësimi i të arriturave të institucioneve të Kosovës në rrjedhat drejt procesit të vendosjes së pavarësisë së Kosovës.

2. Konsideroj se në Kuvendin e Kosovës duhet të sigurojmë një agjendë legjislative që është e mirë dhe që i përmbush nevojat e qytetarëve të Kosovës. Krahas ligjeve më se të domosdoshme nga fusha e ekonomisë, unë do të theksoja sidomos nevojën e nxjerrjes dhe vënies në jetë të ligjeve nga fusha e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Në këtë plan nevojitet edhe nxjerrja e strategjive të caktuara që kanë të

bëjnë me këto fusha, sepse duhet pasur parasysh indikatorët që e dëshmojnë Kosovën si një vend të varfër dhe të pazhvilluar e me gjendje tejet të rëndë sociale e shëndetësore. Në punën tonë duhet pasur kujdes të veçantë në hartimin e ligjeve në përputhje me standardet evropiane dhe mendoj se duhet të intensifikohet angazhimi për realizimin e planveprimit për integrim evropian të Kosovës.

## Gjylnaze Syla



1. Ngritja e kualitetit të ligjeve, ashtu që ligjet të jenë efikase, funksionale dhe në shërbim të çdo qytetari të Kosovës;

Kompletimi i infrastrukturës ligjore, me vënien e kornizës ligjore në pajtueshmëri me standardet evropiane ;

Së bashku me ndërkombëtarët të përpilohet Kushtetuta e Kosovës ; Demonstrimi i tolerancës dhe kulturës politike, bashkëpunimit konstruktiv dhe arritjes së konsensusit, sidomos për çështjet vitale, në interes të Kosovës (arritja e progresit të nevojshëm të standardeve deri në mesin e vitit 2005);

Ushtrimi i funksionit mbikëqyrës mbi qeverinë, për ta mbajtur qeverinë të përgjegjshme;

Fuqizimi i sistemit të komisioneve (forcimi i rolit mbikëqyrës të komisioneve);

Bashkëpunimi i ngushtë me qever-

inë, me OJQ- të, pjesëmarrja aktive në procesin e amendamentimit); Vizitat në terren për të parë se si po zhvillohet programi i qeverisë. Kjo mundëson zbulimin e problemeve në implementimin e programit të qeverisë si dhe zbulimin e ligjeve problematike. Me zbulimin e këtyre ligjeve kërkohet ndryshimi i tyre.

2. Ligjet parësore do të ishin nga fushat e ndërtimit të institucioneve, të sigurisë dhe shtetit ligjor, të ekonomisë dhe të të drejtave pronësore

## Genc Gorani



1. A n g a z h i m i kryesor i deputetëve duhet të jetë në nxitjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës.

2. Ligjet parësore duhet të jenë nga fushat e zhvillimit ekonomik të Kosovës, sigurisë së Kosovës, funksionimit të institucioneve kosovare dhe garantimi i lirisë individuale dhe të asociacioneve joqeveritare.

## Gjergj Dedaj



1. S i p a s mendimit tim, si përfaqësues i demokracisë liberale të Kosovës, përkushtimi imediat i deputetëve të të Kuvendit të Kosovës do të duhej të ishte implementimi i demokracisë dhe konsensusit

brenda për brenda vetë institucioneve të Kosovës dhe ndikimi i tyre për ndërtimin e një shoqërie ligjore, të barabartë dhe vërtetë demokratike në Kosovë.

Aprovimi i ligjeve të aplikueshme dhe konform standardeve evropereëndimore për barazi etnike, fetare, racore dhe gjinore është imperativi i angazhimeve të Kuvendit të Kosovës për t' i paraprirë zgjidhjes së statusit politik të Kosovës, në bazë të vullnetit dhe vetëdeklarimit për vetëvendosje të qytetarëve për hapjen e shtigjeve për integrim në BE dhe në strukturat veriatlantike të Kosovës.

2. Të gjitha ligjet që aprovohen në Kuvendin e Kosovës i kanë prioritetet e veta dhe duhet të jenë në shërbim të qytetarëve të Kosovës dhe të sundimit të ligjit në vend, mbi të cilin nuk duhet të kenë monopol as liderët, as institucionet e Kosovës dhe askush.

Megjithatë ligjet në sferën e ekonomisë, privatizimit, sigurisë për të gjithë qytetarët e Kosovës, pastaj për çështje të arsimit dhe shëndetësisë, të mbrojtjes së familjeve të dëshmorëve dhe të martirëve të Kosovës dhe shtresave të rrezikuara sociale të popullsisë duhet t' i gëzojnë prioritetet e veçanta.

## **SHPRESA MURATI**

1. Pasi që ky vit është vendimtar dhe se është vit kur do të zgjidhen çështje të mëdha dhe



të rëndësishme (standardet, statusi, decentralizimi) për të ardhmen e Kosovës, përqendrimi i angazhimit të deputetëve do të duhej të ishte që secili të japë maksimumin

në fushën e vet. Si përfaqësuese e Bashkësisë boshnjake unë aktivitetet e mia do t' i drejtoj në ruajtjen dhe mbrojtjen e identitetit tonë etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor. Çështje parësore do të jenë përdorimi i gjuhës amtare në çdo rast dhe në të gjitha institucionet publike, arsimit në gjuhën e vet, mundësi të barabarta në aspektin e punësimit, ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe sociale pa diskriminim dhe të ngjashme. Duhet të punojmë në zhvillimin e demokracisë, të sundimit të ligjit, në ngritjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës për mirëqenien e të gjithë qytetarëve të Kosovës.

2. Të gjitha ligjet janë të rëndësishme, mirëpo sipas meje përparësi për miratim në Kuvendin e Kosovës ka Projektligji për prokurorinë publike dhe Projektligji për mbrojtjen e Dëshmitarëve, pastaj Ligji për përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, Projektligji mbi sigurimin shëndetësor, Projektligji mbi trashëgiminë kulturore. Kjo nuk do të thotë se ligjet e tjera janë më pak të rëndësishme, të gjitha e kanë rëndësinë e vetë, por nuk është me rëndësi që vetëm të miratohet një ligj, shumë më e rëndësishme është që të krijohen kushtet për zbatimin e plotë të tyre në praktikë. Në procedurën e mëtutjeshme të Kuvendit është planifikuar edhe analiza dhe miratimi i shumë ligjeve të tjera. Në shumë prej këtyre ligjeve tash për tash të pamiratuara gjenden edhe zgjidhjet ligjore për integrimin e bashkësive pakicë në Kosovë, kështu që prioritetet e mija të mëtutjeshme do të orientohen në gjetjen e zgjidhjeve më të mira ligjore që e gjithë kjo të jetësohet.

**Anëtari i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, Xhavit Haliti, priti shefin e Zyrës Franceze në Prishtinë, Thierry Reynand**

## **Kosova duhet t' i plotësojë standardet për të hapur çështjen e statusit**

*U bisedua edhe për vizitën e anëtarëve të Kryesisë në Paris*



*Takimi Haliti - Reynand*

Zhvillimet aktuale në Kosovë, çështja e funksionimit të institucioneve të vendit, çështja e furnizimit me energji elektrike të qytetarëve dhe çështja e statusit të Kosovës ishin tema bisede e anëtarit të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, Xhavit Haliti, me shefin e Zyrës Franceze në Prishtinë, Thierry Reynand. Është biseduar, ndërkaq, edhe për agjendën e vizitës së anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës në Asambleenë Nationale të Francës.

Shefi i Zyrës Franceze në Prishtinë, Thierry Reynand, ka vlerësuar punën e institucioneve të Kosovës dhe ka shprehur interesin për thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë.

Bashkëbiseduesit janë pajtuar se përm-bushja e standardeve është detyrë mbi detyrat e institucioneve të Kosovës. Ruajtja e stabilitetit dhe të qetësisë politike në Kosovë i ndihmojnë përparimit dhe zhvillimit të vendit, si dhe zgjidhjes së statusit përfundimtar të tij, kanë konstatuar Haliti dhe Reynand.



# Zbatimi i planit të standardeve - përkushtim operativ dhe ditor i Qeverisë

*Programi i Qeverisë siguron bërjen e Kosovës shtet në proces, duke mundësuar vendosjen për statusin final në përputhje me vullnetin politik të popullit të Kosovës*



Kryeministri Ramush Haradinaj paraqet Programin e Qeverisë

Në seancën plenare të 22 dhjetorit të vitit 2004 deputetët solemnisht dhanë betimin. Në vijim Kuvendi kishte në rend të ditës çështjen e zgjedhjes së zëvendësministrave të Qeverisë së Kosovës. Kryeministri Ramush Haradinaj theksoi se pasi janë bërë përgatitjet e duhura janë evidencuar kandidatët për zëvendësministra nga koalicioni qeverisës. Në bazë të kësaj propozohen këta kandidatë:

**Z. Hafiz Krasniqi** - zëvendësministër në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit ( ekonomist i diplomuar );

**Z. Astrit Ajeti** - zëvendësministër në Ministrinë e Shëndetësisë ( doktor);

**Z. Muharrem Ibrahim** - zëvendësministër në Ministrinë për Ekonomi e Financa ( ekonomist i diplomuar );

**Z. Fevzi Berisha**, zëvendësministër në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;

**Z. Aziz Lila**, zëvendësministër në Ministrinë e Pushtetit Lokal;

**Z. Merxhan Avdyli**, zëvendësministër në Ministrinë e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;

**Z. Kadri Kryeziu**, zëvendësministër në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë;

**Z. Agron Dida**, zëvendësministër i Ministrisë së Energjetikës dhe Minierave;

**Z. Lulzim Leci**, zëvendësministër në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

**Z. Mark Komoni**, zëvendësministër në Ministrinë e Shërbimeve Publike;

**Z. Angelina Krasniqi**, zëvendësministre në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport;

**Z. Ibish Bajrami**, zëvendësministër për Ministrinë e Kthimit dhe të Minoriteteve;

**Z. Tomë Hajdaraj**, zëvendësministër në Ministrinë e Pylltarisë dhe

Zhvillimit Rural;

**Z. Ergyn Koruglu**, zëvendësministër të dytë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve Jorezidente dhe

**Z. Nazmi Fejza**, zëvendësministër të dytë në Ministrinë e Kthimit dhe të Minoriteteve.

Për listën e zëvendësministrave votuan 66 deputetë, një votë ishte kundër, ndërsa 34 deputetë abstenuan. Në vijim zëvendësministrat dhanë betimin.

## Opozita trajtohet si pjesë integrale e demokracisë

Në vijim kryeministri i Kosovës, zotëri **Ramush Haradinaj**, bëri prezantimin e Programit të Qeverisë . Në fillim z. Haradinaj theksoi se në këtë kohë, ne gjithsesi duhet t'i kujtojmë të gjithë ata që u flijuan për lirinë e vendit dhe të gjithë ata që me vite punuan pa

kursyer asgjë, që një ditë populli i Kosovës t'i gëzohet lirisë dhe pavarësisë. Ne ju kemi borxh të përjetshëm të gjithë atyre që ranë në altarin e lirisë, që të bashkohemi në detyrat tona të përbashkëta për të krijuar një shtet me shoqëri demokratike dhe tolerante.

Sot, për herë të parë në historinë tonë të re të Kosovës, kemi një Qeveri dhe një opozitë. Unë pres që opozita do të ofrojë zgjidhje alternative dhe se do të jetë konstruktive në veprimet e saj, si dhe do të na nxisë në punën tonë për të mirën e përbashkët. Opozita ka premtimin tonë se kjo Qeveri do ta trajtojë atë si pjesë integrale të demokracisë sonë. Qeveria e Kosovës ka bërë gati Programin e saj, në të cilin ka bashkuar aspekte programore për qeverisjen e suksesshme në tre vjetët ardhshëm, për zhvillimin e Kosovës në të gjitha fushat e jetës, për një zhvillim që do të jetë i qëndrueshëm dhe në rritje të vazhdueshme. Programi në vete ka të shkrirë agjendën e standardeve për Kosovën, që do të mundësojë realizimin e tyre me sukses.

Po ashtu, Programi i Qeverisë siguron bërjen e Kosovës shtet në proces, duke mundësuar vendosjen për statusin final në përputhje me vullnetin politik të popullit të Kosovës. Në programin e Qeverisë nuk është përfshirë platforma për negociata për statusin final të Kosovës, sepse një platformë e tillë do t'i prezantohet Kuvendit të Kosovës në kohën e duhur.

Të vetëdijshëm për përgjegjësinë e koalicionit qeveritar, para Kuvendit dhe qytetarëve - promovojmë këto prioritete të veprimit.

Si prioritet të parë kemi – standardet dhe statusin.

Pastaj me radhë:

- Forcimin e institucioneve; përmirësimin e qeverisjes dhe plotësimi i kuadrit ligjor;

ndërtimin e një administrate publike të përgjegjshme dhe të shtetit ligjor; rritjen ekonomike dhe punësimi; arsimin dhe edukimin, sipas standardeve ndërkombëtare; ngrit-

jen e cilësisë së shërbimeve publike dhe zhvillimin e infrastrukturës; forcimin e stabilitetit politik dhe të sigurisë dhe avancimin në procesin e integritit evropian dhe euroatlantik, si dhe ndërtimi i raporteve të mira me fqinjët.

Zbatimi i planit të standardeve do të jetë përkushtim operativ dhe ditor i Qeverisë, duke siguruar një bashkërenditje të veprimeve dhe monitorim efektiv ndërinstitucional. Do të sigurohet një bashkëpunim i ngushtë me UNMIK-un dhe institucionet tjera të Kosovës, por edhe të gjitha organizatave në angazhimin e të gjitha instrumenteve qeveritare dhe strukturat civile të shoqërisë së Kosovës.

Duhet të jemi të qartë se zbatimi me sukses i standardeve do të reflektohet pozitivisht në statusin përfundimtar politik, në rrugën evropiane të Kosovës dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe në performancat e institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse.

Forcimi i institucioneve është synim i parë i Qeverisë dhe këtë nëpërmjet kompletimit të Qeverisë edhe me ministritë e nevojshme. Ne po ashtu do të veprojmë që të përmirësohet kultura e qeverisjes dhe të shtohet efikasiteti i administratës shtetërore. Formimi i ministrive të reja do të jetë në funksion të ushtrimit të kompetencave të transferuara në këto institucione dhe në kuadër të këtij prioriteti Qeveria do të fokusohet sidomos në: ngritjen e kapaciteteve dhe të infrastrukturës institucionale; kompletimin e Qeverisë me ministri tjera të nevojshme; fillimin e punës për hartimin e Kushtetutës së Kosovës – me inkorporim të standardeve dhe normave evropiane dhe paralelisht me propozimin për definimin e statusit final dhe aprovimin e kushtetutës; funksionimin e ekonomisë së tregut; rritjen e efektivitetit në qeverisje; marrjen e masave korrigjuese dhe preventive me qëllim të realizimit efektiv të objektivave; krijimin e parakushteve për lehtësimin e rolit

monitorues dhe korrektues të UNMIK-ut në pajtim me mandatin e tij.

- Rritja ekonomike dhe punësimi konsiderohen si shtylla të rëndësishme të stabilitetit të përgjithshëm në shoqëri. Të gjitha potencialet e vendit dhe përkrahja ndërkombëtare duhet të orientohen për sigurimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe hapjes së perspektivës për punësim produktiv. Kërkesat për punësim në këtë moment janë të papërbalueshme për shoqërinë dhe ekonominë kosovare, nëse nuk sigurojmë rritje ekonomike dhe investime në infrastrukturë dhe arsimim më të mirë për rininë tonë.

Përmirësimi i pozitës së bujqësisë, në kuadër të politikave fiskale, duhet të shoqërohet edhe me masa shtesë për të siguruar një qëndrueshmëri në zhvillimin rural dhe të bujqësisë.

Formimi i ministrisë së energjetikës dhe minierave, është rast i mirë për adresimin e problemeve bazike në funksionimin e këtyre sektorëve.

Janë të nevojshme disa veprime urgjente lidhur me zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale për të përmirësuar qëndrueshmërinë financiare të KEK-ut dhe definitivisht ndërprerjen e angazhimit të mjeteve buxhetore për këtë kompani dhe kompanitë tjera publike.

Në funksion të ndryshimit të situatës aktuale, paralelisht duhet sforcuar detyrimin administrativ të pagesës së borxheve tani të papërbalueshme për KEK-un për energjinë e shpenzuar. Kjo kërkon shqyrtimin e mundësive për formimin e një skeme subvencionuese për rastet sociale.

Qeveria do të ndërmarrë masa të përqendruara në tejkalimin e vështirësive dhe dobësive lidhur me aspektet menaxhuese të infrastrukturës dhe teknologjisë mësimore e financiare dhe vazhdimin e reformimit të arsimit në të gjitha nivelet.

Në kuadër të kulturës, do të

mbështetet pasurimi i identitetit kulturor të qytetarëve; mbrojtja dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore dhe kombëtare; nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar kulturor si dhe restaurimi i objekteve fetare të shkatërruara më herët apo edhe gjatë ngjarjeve të marsit 2004.

Në kuadër të sportit, do të realizojmë synimin për ndërkombëtarizimin e sportit kosovar dhe po ashtu duke i dhënë mbështetje sportit në Kosovë do të fokusohemi në evidencimin e parregullsisë në sport dhe në gara sportive.

Kujdes i veçantë do të tregohet ndaj bartjes së kompetencave në drejtim të pushtetit lokal, me qëllim që pushteti t'u ofrohet të gjithë qytetarëve, veçanërisht minoriteteve, duke rritur mundësinë e veprimit të tyre institucional për qasje të barabartë në shërbime dhe për realizimin e të drejtave të tyre mbi parimet e multietnicitetit.

Decentralizimin e kuptojmë si praktikë për reformën e pushtetit lokal, duke përmirësuar qeverisjen dhe rritjen e participimit të qytetarëve në vendimmarrje. Ky reformim duhet të fillojë me nxjerrjen e legjislatcionit, siç janë ligji mbi pushtetin lokal, ligji mbi financat publike dhe ligjet tjera. Do të vazhdohet puna rreth rrumbullakimit të një koncepti mbi decentralizimin, duke inkuduar në proces të gjitha institucionet, administratën ndërkombëtare, shoqërinë civile, por edhe minoritetet.

Prioritet i Qeverisë do të jetë luftimi i korrupsionit në administratën shtetërore, por po ashtu edhe luftimi i krimit të organizuar e të rëndë, kriminalitetit ekonomik, sulmeve ndaj jetës e pasurisë së qytetarëve pa dallim përkatësie etnike, gjinore apo politike.

### **Kujdes i veçantë ndaj familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës**

Me prioritet do të trajtohen çështjet dhe kontestet pronësore lidhur me uzurpimet e paligjshme, duke zbatu-

ar me urgjencë rikthimin e pronave të uzurpuara dhe duke punuar për kthimin e të shpërngulurve edhe të minoriteteve, duke përfshirë edhe tejkalimin e ngecjes në kthimin e qytetarëve serb të Kosovës të shpërngulur nga Kosova.

Qeveria në Program ka një qasje të veçantë për kategoritë meritore për lirinë e Kosovës. Do të veprojë në bazë të përgatitjeve të bëra, për kujdes ndaj familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, familjeve të martirëve dhe të zhdukurve. Po ashtu, Qeveria ka ndërmarrë veprime dhe do të punojë për ta zgjidhur më shpejt çështjen e personave të zhdukur dhe për këtë do të kërkojë edhe angazhimin më të vendosur të faktorit ndërkombëtar.

Qasja e Qeverisë së Kosovës për tejkalimin e sfidave dhe krijimin e një stabiliteti demokratik, politik dhe socioekonomik bazohet në forcimin e partneritetit me komunitetin ndërkombëtar, në veçanti me BE-në, SHBA-në, NATO-në, por edhe me Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe organizata, institucione dhe agjenci të tjera ndërkombëtare. Ky bashkëpunim do të reflektojë siguri dhe stabilitet, paqe të qëndrueshme, fqinjësi të mirë dhe ajo që ka rëndësi praktike dhe strategjike për Kosovën – sukses në zbatimin e standardeve dhe hapjen e perspektivës integruese evropiane dhe evroatlantike. Ne do të jemi përgjegjës ndaj rendit ndërkombëtar dhe do të veprojmë në pajtim me ambiciet tona për forcimin e imazhit të Kosovës si vend demokratik dhe prosperues, theksoi Ramush Haradinaj.

### **Kufijtë ekzistues të Kosovës të mbrohen në përputhje me parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare**

Duke marrë pjesë në diskutim Hashim Thaçi theksoi se në vend që Programi qeveritar të prezantohet e debatohet fillimisht, e pas aprovimit të Programit të zgjedhet

Qeveria, siç e do rendi e rregulla demokratike parlamentare, këtu tek ne ndodhi e kundërta. Sikur jemi duke i kushtuar më tepër rëndësi shfaqjes së jashtme sesa ndërtimit të institucioneve të njëmendta shtetërore.

Programi qeveritar është një përktim i mirë, por është abstrakt. Nuk ka substancë. I mungon vizioni, më tepër i ngjan një punimi studimor teorik sesa programit politik e zhvillimor. Programet qeveritare nuk ndërtohen vetëm nga hulumtimet e opinionit publik për t'i treguar brenat e qytetarëve, siç bën kjo strukturë qeverisëse, por duke i hulumtuar ato dhe duke na bindur me gjetjen e formave më të mira dhe adekuate për zgjidhjen e kërkesave të qytetarëve dhe afatizimin e tyre.

Partia Demokratike e Kosovës, vlerëson se duhet të qartësohen edhe më mirë këto aspekte të Programit të Qeverisë, duke bërë këto rekomandime dhe plotësime në vijim:

1. Të bëhet program qeveritar angazhimi kryesor për Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe të integruar në strukturat veriatlantike.
2. Të specifikohen edhe më qartë dhe në mënyrë më të avancuar të drejtat e barabarta për të gjithë qytetarët – si Kosovë vend shumetnik dhe shumëfetar.
3. Sa i përket sundimit të ligjit, do të duhej të bëhet një zotim më specifik dhe konkret për:
  - ndërtimin e bazës ligjore dhe legjislatcion me interes të gjithë qytetarëve;
  - Përkushtimin dhe afatizimin e periudhës kohore për nxjerrjen e një kushtetute në përputhje me ato të shteteve demokratike perëndimore.
  - Gjyqësinë e pavarur e të paanshme të përgjegjshme ku të gjithë qytetarët do të jenë të barabartë para ligjit;
  - Masa rigorozë antikorruption në të gjitha segmentet e institucioneve me zbatim të barabartë në të gjitha nivelet;
  - Zotimin dhe afatizimin kohor për



hedhjen poshtë të të gjitha ligjeve serbe të aplikueshme në Kosovë. Edhe sot e kësaj dite për fat të keq ende ligjet e kohës së Milosheviqit janë të aplikueshme në “drejtësinë - në thonjëza – kosovare”;

- Pjesëtarët e strukturave paralele, e “rojave të urës” që si destabilizues për vendin të dirigjuara nga Serbia të kemi përkushtim të qartë dhe konkret të Qeverisë për t’u ballafaquar me ligjin;

4. Sa i përket funksionimit të qeverisjes së Kosovës, si shoqëri moderne, duhet pasur parasysh veçanërisht:

- funksionimin e shërbimit civil modern dhe profesional, me status të mbrojtur me ligj;

- të ndalet fushata e qeveritarëve të rinj të motivuar politikisht për largimin nga puna të njerëzve profesionist të administratës publike;

- zotimin që në të ardhmen, në bashkëpunim me partitë politike, shoqërinë civile, me mekanizmat ndërkombëtar – të ndodhin reforma në sistemin zgjedhor me aplikimin e listave të hapura për një parlament më të përgjegjshëm ndaj nevojave të gjithë qytetarëve;

- pagat në sektorin publik të jenë konkurrencte me ato në sektorin privat;

- shoqëritë aktive civile dhe mediat të jenë plotësisht të lira dhe të pavarura;

- të hiqet dorë nga praktika e qeveritarëve të rinj që këtyre ditëve ushtrojnë trysni për kontrollin ndaj mediave por edhe të mos lejohet më tutje korrupsioni publik. Për korrupsionin publik më mirë e dinë editorët e gazetave të ndryshme.

5. Në pjesën e Programit për zhvillimin ekonomik, duhet pasur kujdes:

- Prioritetin e inkuadrimit të plotë të Kosovës në eurozonë me euro si valutë;

- Përshpejtimin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet fqinje dhe vendet tjera...

6. Në drejtim të mirëqenies sociale duhet të ketë asistencë sociale për

## Kundërpërgjigje Daci – Surroi mbi korrupsionin

NEXHAT DACI propozoi që nga procesverbali të hiqet fjalia ku zoti Surroi e merr rolin e prokurorit, sepse ky është dokumentacion zyrtar dhe të mos emërtohen “korrupsioni të luftohet mbi të gjitha bazat ligjore, normative”. Pajtohem me krejt atë, por të mos figurojnë “në ministri dhe komunë”, sepse ajo kërkon pastaj procedurë të veçantë. Kryetarët e partive duhet në Program t’i japin vërejtjet dhe ato të mundohemi pastaj t’i aplikojmë, prandaj ju lutem që herëve tjera të mos merremi me këto çështje. Unë e kam këtë të drejtë, por dua që edhe zoti Surroi të pajtohet me të, në mënyrë që të jemi efektiv në të gjitha të metat që i kemi pasur gjatë periudhës së kaluar dhe ato të mos përsëriten.

Zoti Surroi, po e përsëris - unë po ju lus që atje ku keni përmendur emra të veçantë, sikur që janë theksuar komunë e caktuar dhe ministri të caktuara - në qoftë se keni argumentim ky argumentim le t’i dorëzohet Parlamentit dhe ne pastaj do ta paraqesim në procedurë të rregullt, ku duhet. Kuptohet me pëlqimin tuaj të fshihet nga pjesa zyrtare e dokumentacionit të Parlamentit ajo fjali ku përmendni emra. E kuptoj se keni të drejtë të insistoni, por atëherë e merrni obligimin që të siguron dokumentacionin, theksoi Daci.

VETON SURROI duke u përgjigjur tha se nuk jam për heqjen e emrave, siç thashë - zgjedhja e ministrive është bërë në mënyrë që të identifikohet se nuk është çështje e një partie. Unë flas për hulumtime të perceptcionit për korrupsion në këto ministri, nuk flas për hulumtime të cilat identifikojnë korrupsion në këto ministri. Prandaj nuk jam për heqjen e emrave, por po e riformuloj pra kështu: Kërkoj nga Qeveria që të formojë grupe të cilat do të rivlerësonin procesin e tenderimit në këto ministri për të treguar lidhur me bazueshmërinë apo jo të perceptcionit për korrupsion në këto ministri dhe natyrisht për Komunën e Prishtinës. Unë nuk e eliminoj besimin tim apo mosbesimin tim në procesin tenderues. Unë them se ekziston një perceptcion për korrupsion në këto ministri dhe në komunën e Prishtinës, atëherë po e la anash se ajo ishte vetëm ilustrim i degjenerimit në shoqërinë tonë, por në mënyrë që kjo Qeveri të fillojë me duar të pastra apo me një projekt të duarve të pastra në qeverisje do të duhej të jepte raport për perceptcionin e keq qeverisjes së mundshme në qeverinë e kaluar.

NEXHAT DACI tha se perceptimi është e drejtë individuale, kjo nuk ka implikime në dokumentacion. Unë po ju propozoj që të jetë si përgjithësim që Qeveria e re mund të bëjë vlerësime dhe të mos përsëriten, por prap po ju lus pa emra të ministrive dhe të komunave, edhe në perceptcion do të jetë në dokumentacion keq, megjithatë në perceptcion keni të drejtë, nuk kërkoj të shlyhet, por po ju lus që të keni mirëkuptim dhe të mos fillojmë menjëherë kështu, por është edhe e drejtë juaja.

qytetarët që nuk kanë mundësi t’i përmbushin nevojat elementare për veten dhe familjet e tyre:

Mendoj se në programin e Qeverisë do të duhej patjetër të definohet qartë çështja e veteranëve dhe të invalidëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e të mos kihet turp që të futet formulimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të mos ketë ndajre familjare apo lokaliste në përkujdesjen ndaj familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe veteranëve të luftës siç po ndodhë.

Gjithashtu përkujdesje edhe më e theksuar për familjet e viktimave civile dhe invalidët civil të luftës.

7. Në aspektin e mbrojtjes dhe të sigurisë.- Kufijtë ekzistues të Kosovës të mbrohen në përputhje me parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare:

Garancionet e sigurisë nga NATO -

ja duke përfshirë edhe zhvillimin e forcës mbrojtëse të Kosovës, sot TMK të integruar në të ardhmen e afërt në NATO.

8. Bashkëpunimi me shtetet fqinje duke respektuar sovranitetin dhe integritetin territorial të njeri tjetrit:

9. Përkrahje më kuptimplotë nga Qeveria për integrimin e të kthyerve dhe mbrojtjen e trashigimisë kulturore të komuniteteve.

E meta më e madhe e këtij Programi qeverisës, shprehu mendimin **Veton Surroi**, është se në masë të madhe juridikisht do të jetë Qeveri ose qeverisje e kontinuitetit në kuptimin juridik të fjalës.

Koncepti juridik i propozuar në këtë Program qeverisës është koncept i cili vazhdon të mbajë dy, tri apo katër sisteme juridike të ndryshme brenda territorit të

Kosovës.

Atë çka nuk e kemi këtë Program qeverisës, përkundër premtimit se do të hartohet kushtetuta e Kosovës - është unifikimi i sistemit juridik kosovar. Edhe po të hartohej kushtetuta e Kosovës në një afat shumë të shkurtër, megjithatë Kosova do të duhej të kalonte nëpërmjet të unifikimit të sistemeve të ndryshme legale në Kosovë, që nga ato të vitit 1989 e deri te rregulloret e UNMIK-ut. Ky është obligim edhe e kësaj Qeverie, edhe të këtij Parlamenti.

Koncepti, siç e thashë, i zhvillimit ekonomik nuk përputhet me urgjencën që ka Kosova në disa prej fushave elementare, por merr përsipër formulat e dhëna nga Banka Botërore apo nga OJ-ët e ndryshme. Edhe e meta e tretë e evidencuar në këtë Program qeverisës nga aspekti strukturor është se ekziston një shpërputhje në mes obligimeve që ka marë Qeveria dhe kapacitetit intelektual apo menaxherial të disa prej anëtarëve të Qeverisë të cilët nuk mund t' i përgjigjen këtyre sfidave.

KEK-u PTK-ja RTK-ja janë ndërmarrje të cilat në masë të madhe absorbojnë para publike, por nuk janë ndërmarrje të cilat mbikëqyren nga ana e publikut dhe kjo do të duhej të ishte një detyrë qeveritare. Mendoj se në këtë Program qeverisës nuk jepen përgjigje për këto pyetje: çfarë do të jenë masat stimulative për rritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, posaçërisht sa mund të jenë më stimulative se sa janë ato në rajon. Domethënë duhet kontekstualizur problemin e stimulimit të ndërmarrjeve. Çfarë do të jetë stimulimi infrastrukturor, çfarë ai fiskal, çfarë ai i politikës kreditore. Si mund të vazhdohet me procesin e privatizimit siç premtonte Qeveria nëse ky koncept i privatizimit nuk e parasheh të drejtën pronësore kosovare, është i kontestueshëm nga ana e UNMIK-ut dhe është i drejtuar kah shitja e patundshmërisë, e jo shitja e kapacitetit prodhues ekonomik me

çka do të degradohet edhe më tutje struktura prodhuese e Kosovës. Si do ta përfshijë Qeveria AKM-ën brenda vetes?

Përgjigje nuk kemi dhe çfarë do të bëhet me sistemin bankar.

Sugjerohet që ky program t' i rikthehet Qeverisë, të konkretizohet, të afatizohet. Dhe në fund mendoj se nuk mund të flitet për korrupsion në sistemin tonë apo në luftë kundër korrupsionit nëpërmes një agjencie. Unë mendoj se kjo Qeveri dhe ky Parlament duhet të shkëpusin kontinuitetin me korrupsionin e qeverisjes së kaluar dhe këtë duhet ta bëjë nëpërmjet raportit të së paku 4 ministive, ku kan qenë shefa njerëz nga parti të ndryshme dhe të demonstronhet nëpërmjet rivlerësimit të tërë procesit të ritenderimit – për shembull në Ministrinë e Arsimit, në Ministrinë e Shëndetësisë, në Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe në atë të Telekomunikacionit dhe Lidhjeve dhe a ka ekzistuar apo jo siç është përfolur gjatë këtyre tre viteve një indikator aq i lartë i korrupsionit sa ta hetojë popullata.

Unë mendoj se është obligim i Qeverisë që të prezantojë një raportim të këtyre në mënyrë që të tregojë se nga dita e parë ka parashikuar luftën kundër korrupsionit, si një luftë reale e jo si një vizion të ndërtimit të një strategjie apo të një agjencie.

**Alush Gashi** shfaq mendimin se janë impresiv objektivat e shtruar, realizimi i të cilave do ta bëjë vendin tonë më të mirë dhe të pranueshëm. Në këtë proces do të mirëprisnim ofrimin e argumenteve të nevojshme për të dëshmuar mundësinë e realizimit të asaj që nevojitet dhe dëshirohet sot këtu, gjë që të cilën e presin qytetarët e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare.

Shkalla e zhvillimit të një vendi varet nga niveli i zhvillimit të diturisë shkencore dhe aplikimit korrekt të saj. Andaj edhe kërkojmë një përkushtim më të theksuar në ngritje të nivelit të gjithmbarshëm të

edukimit institucional, sepse për ndërtim të shoqërisë demokratike nevojitet dije në të gjitha lëmenjtë. Jetojmë në kohë të ndërvarshmërisë globale, është koha e dijës. Z. Kryeministër, edhe përkundër kufizimeve eventuale kushtetuese do ta mirëprisnim paraqitjen e vizionit, nëse edhe jo vendimin e Qeverisë, për strukturat e mbrojtjes dhe sigurisë së Kosovës, për hapjen e përfaqësive të Kosovës jashtë vendit, në veçanti në Unionin Evropian, në Organizatën e Kombeve të Bashkuara si dhe vizionin e Qeverisë për zbatimin e ligjeve të miratuara në Kuvendin e Kosovës dhe mbi të gjitha do ta mirëpresim argumentimin për mundësinë e hapjes së vendeve të punës për të cilat flitet sot këtu. Të vetëdijshëm se shansi i Kosovës është demokracia e qëndrueshme, ku të gjithë qytetarët do të kenë shans të njëjtë dhe do të jenë të barabartë para ligjit, angazhohemi që në vendin tonë të ketë paqe, drejtësi dhe prosperitet.

**Jakup Krasniqi** u shpreh se hartuesi i Programit të Qeverisë së koalicionit nuk ka pasur informacione të mjaftueshme për punën dhe aktivitetin e Qeverisë së shkuar.

Do të përpiqem, duke shkëputur pjesë nga programi, që mendoj se duhet të ndryshohen. Që në hyrje të Programit Qeveria konstatojë se Kosova gjendet para sfidave të vështira dhe para momenteve historike. Po citoj nga programi: “Kur duhet të bëjë hapa vendimtarë në realizimin e vullnetit politik të qytetarëve të vet për ndërtimin e një shoqërie të lirë dhe demokratike”. Vullneti politik i secilit popull realizohet përmes përfaqësuesve të zgjedhur të deputetëve në Parlament, ose përmes referendumit gjithëpopullor. Këtu nuk është thënë asnjëra në program.

Në paragrafin e 4 pika 2.1 bie në kundërshtim me atë që thuhet në hyrje. Tani thuhet: “Qeveria do të bashkëpunojë me UNMIK-un dhe komunitetin ndërkombëtar që bisedimet lidhur me statusin përfundimtar të Kosovës të fillojnë

në kohën e paraparë”. Kur është paraparë ajo kohë, kush duhet ta zgjidhë statusin e Kosovës, qytetarët e Kosovës me referendum apo Qeveria me UNMIK-un dhe komuniteti ndërkombëtar.

Kjo nuk është e sqaruar. Më vonë thuhet se gjatë 5 vjetëve të kaluar, ky është konstatim, UNMIK-u dhe institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes përmbyllën me sukses fazën emergjente. Në 5 vjetët e kaluar në Kosovë ka pasur të arritura, ka pasur suksese, por ta ndërtohet programin e Qeverisë mbi premisën e gabuar se në Kosovë është përmbyllur faza emergjente, do të thotë të mos dish nga duhet nisur, do të thotë mosnjohje e realitetit në Kosovë dhe krejt programi të nisur nga premisa të gabuara. Se sa duhet të jetë i mirë dhe i realizueshëm një program i tillë unë nuk dua ta paragjykojë.

Ndoshta për ne që gjendemi në këtë sallë të Kuvendit kemi përmbyllur me sukses fazën e ndërtimit emergjent, por kjo nuk mund të thuhet për shumë qytetar. Nuk e kanë zgjidhur çështjen ma emergjente edhe shumë ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ata që na kanë sjellë këtu në këtë Parlament e institucione me mundin, gjakun dhe pjesët e trupit të tyre.

**Gjylnaze Sylja** tha se ne përfaqësuesit e zgjedhur në Kuvend kemi përgjegjësinë që gjatë këtij mandati të sjellim ligje të mençura efikase dhe evropiane, që janë në shërbim të çdo qytetari të Kosovës. Ne duhet të rindërtojmë komunitetet tona rurale dhe urbane. Ne duhet të krijojmë klimën e mirëbesimit përmes komunikimit më të mirë ndërmjet komuniteteve - shumicës dhe pakicës dhe të nxisim integrimin e bashkësive etnike, sidomos asaj serbe në shoqërinë kosovare.

Kemi dëshirën dhe vullnetin për ta bërë këtë dhe do t'i përdorim të gjitha mjetet që kemi që integrimi të jetë i suksesshëm. Por, njëkohësisht ftojme qytetarët serbë të Kosovës të tregojnë dëshirën për t'u integruar

në proceset demokratike dhe shoqërinë kosovare.

Kërkesat e qytetarëve për liri e paqe të qëndrueshme dhe zhvillim ekonomik janë përgjegjësi e secilit qytetar sidomos e neve që përfaqësojmë atë, por edhe e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë. Liria e të gjithëve duhet të jetë e siguruar dhe ligjet duhet të vlejnë për të gjithë njësoj.

Krijimi i infrastrukturës ligjore që garanton sigurimin e investimeve, Ligji për garantimin e investimeve, Ligji për koncesionet;

Politika programore për nxitjen e zhvillimit të sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

Stimulimi i bizneseve përmes shkarkimit të bizneseve nga tatimi dhe doganat; shërbimet efikase tati more në mes zhvillimit të kapaciteteve të administratës tati more; sistemi efektiv i prokurimit, Menaxhimi efikas i buxhetit të Kosovës,

Politika efikase monetare kreditore dhe përmes krijimit të bankës qendrore, shndërrimit të autoritetit të pagesave në bankë qendrore.

Plotësimi i kuadrit ligjor me 23 projektligje dhe akte parësore të parapara deri kah mesi i vitit 2005 e bën shoqërinë tonë më funksionale, sepse nga këto këto 36% janë për ndërtimin e institucioneve demokratike dhe stabile, 18% janë për siguri dhe shtetin ligjor, 13% për ekonomi dhe 13% për të drejtat pronësore.

**Ylber Hysa** duke folur rreth pjesës së Programit që ka të bëjë me politikën e standardeve, theksoi se në raportin në mes të politikave dhe të standardeve dhe të qasjes ndaj statusit final, hetohet një inkoekzistencë programore. Nëse Qeveria zotohet me besnikëri ndaj politikës së standardeve, në asnjë moment nuk qëndron se do të përfillet vullneti politik i qytetarëve të Kosovës në përcaktimin e statusit final të Kosovës. Dilema bëhet më e madhe kur kësaj t'i shtohet zotimi tjetër për angazhimin tjetër për bisedime të shpejtuara në një varg adresash me

rëndësi të institucioneve ndërkombëtare. Qeveria nuk dallon në shpjegimin e saj nëse Këshilli i Sigurimit është adresa ku do të kërkohet zgjidhja për të filluar, siç thuhet, negociatat e shpejtuara dhe vendimet për pavarësinë e Kosovës, apo siç thuhet edhe në Bashkësinë Evropiane, Shtetet e Bashkuara apo Grupin e Kontaktit. Nëse është kështu, atëherë pretendimi për të adresuar statusin në mënyrë të shpejtuar, të elaboruar jo më shumë se në disa paragrafe në programin qeveritar duket se i mungon serioziteti i qasjes dhe shtjellimit për të qenë bindës për një aprovim parlamentar. **Mahir Jakgjillar** tha se sfida më e madhe, sikurse kuptohet nga programi i propozuar është realizimi i standardeve për Kosovën. Me siguri që si përfaqësues të zgjedhur të bashkësisë turke dhe boshnjake, gjatë punës - kujdesin më të madh do t'ia kushtojmë të drejtave dhe interesave të bashkësive turke dhe boshnjake, por nuk do t' i lëmë anash, as përgjegjësitë tjera të cilat i kemi si qytetarët të Kosovës në zhvillimin dhe mbrojtjen e gjuhës turke dhe boshnjake, arsimimin në këto gjuhë, botimin e librave sipas programit kosovar në këto gjuhë, zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës dhe identitetin e këtyre bashkësive.

### **Standardi numër një është Kosova e pavarur**

**Sabri Hamiti** theksoi se është koha - momenti edhe historik dhe aktual që në këtë Kuvend për çështjet e mëdha që e presin Kosovën të mund të krijohet bashkimi i shumicës absolute që tejkalon këto pjesëtime politike. Kujtoj që edhe në kuptimin nacional edhe në kuptimin përtej nacional, ose të pakicave tjera, këtu në këtë formë krijohet një shumicë absolute që mund të krijojë vendimet e mëdha.

Një problem i dytë që këtu mund të dalë në diskutet edhe të programit, po edhe politike, po edhe ato që ndodhin përditë në jetën praktike dhe shoqërore, problemi i standard-



eve.

Unë mendoj që standardi numër një, kur është fjala për standarde - është Kosova e pavarur dhe të gjitha tjerat ose janë derivime të kësaj ose nuk kanë shans që të plotësohen, por ne mund të vazhdojmë me fjalime retorike rreth tyre.

Standardet e tjera, po them, nëse projektohen si vonesa për statusin e Kosovës, unë jam i bindur që nuk do të jenë blerje e kohës, por do të jenë humbje e kohës për Kosovën dhe fundi i fundit ky qëndrim imi është i rishpallur edhe një herë sot dhe i paraqitur në Kuvend edhe më herët. Sepse partitë politike që janë në Kuvend e kanë obligim edhe qytetar edhe përfaqësues, më në fund edhe në bazë të programeve që i kanë afishuar pa u ndalur nëpër fushata zgjedhore - i kam parasysh të gjitha partitë pa përjashtim - kanë thënë se ky është standardi numër një i tyre.

**Bajram Rexhepi**, duke folur për pjesën e aspektit ekonomik të programit tha se ekonomia e Kosovës e sidomos sektori privat ka uri për mjete të gatshme financiare, të cilat janë të bllokuara në formë depozitash nëpër bankat e ndryshme komerciale; mjetet e Trustit pensional në tregjet e parave në Holandë, fondi nga asetet e shitura të ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara është po ashtu i bllokuar, mjetet e pashfrytëzuara dhe tepricat e PTK-së, Aeroportit e tjerë. Dhe për këtë, kjo Qeveri duhet të gjejë sa më parë mënyrën e mobilizimit të këtyre mjeteve për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ose të ndërmarrjeve publike.

**Naim Maloku** duke dhënë disa sugjerime shprehu shqetësimin lidhur me nxjerrjen e mjeteve financiare jashtë tregut të kapitalit të Kosovës. Fjalën e kishte për Trustin Pensional të Kosovës, që kap një vlerë rreth 70 deri 100 milionë euro. Ai shprehu rezervën për manipulimet me këto mjete financiare jashtë Kosovës dhe frikën që këto mjete financiare do të përfundojnë, ashtu siç ka përfunduar edhe Fondi

Pensional i Rumanisë me humbjen e dhjetëra milionë eurove pa kthim. Mjetet tjera financiare që janë larguar nga tregu i kapitalit të Kosovës janë edhe mjetet e Postë Telekomit të Kosovës. Këtu spekulohet me qindra miliona euro. Mendoj se Qeveria e Kosovës duhet të bëjë çmos që këto mjete financiare t' i kthejë në tregun e kapitalit në Kosovë, që do të ishte një ndihmë e madhe për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

**Teuta Sahatqia** përmendi faktin se shoqëritë aksionare deri më sot nuk

paguajnë tatime. Prandaj po i drejtohem Qeverisë dhe zotit Kryeministër që, duke pasur parasysh këte, të kërkojmë që të futet në Programin e Qeverisë edhe kjo çështje.

**Emrush Xhemajli** theksoi se nga pjesët programore me të cilat pajtohet LPK-ja është përpunimi i ligjit në procedim për dëshmorët, invalidët dhe veteranët e luftës çlirimtare. Gjithashtu, përkrahim listën e ligjeve që ka ofruar Qeveria si shtesë të Programit, duke shpresuar që ndërkohë do të shtohen edhe ligje të



janë përfshirë në privatizim dhe nuk shihet një rrugë e zgjidhjes e statusit të tyre. Këto ndërmarrje janë transformuar në shoqëri aksionare me ligjin diskriminues të kohës së Ante Markoviqit mbi kapitalin shoqëror. Ato as nuk janë të regjistruara, pasi që nga Ministria e Tregtisë deri më sot nuk është përgjigjur në kërkesën e këtyre shoqërive aksionare për regjistrim si biznese. Si të tilla ato nuk mund të ushtrorjnë aktivitetin e vet të plotë ekonomik, nuk kanë mundësi të importit dhe eksportit, nuk mund të aplikojnë në tendera, të kenë konton e vetë e tjera. Ndërsa, në të njëjtën kohë - ato nuk pengohen të

tjera të nevojshme.

Në veçanti përkrahi pjesën ku flitet për angazhimin e Qeverisë, për regjistrimin e popullsisë si dhe pjesët që i kushtohen diasporës. Qeveria e Kosovës duhet të iniciojë procedurën para organeve të drejtësisë kundër pjesëtarëve të okupatorëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre që bënë masakra mbi popullsinë civile në Kosovë.

**Gjergj Dedaj**, duke u përqendruar në çështjet e marrëdhënies ndërkombëtare tha se në Program nuk vërehet as afatizimi, as instrumenti, as ndonjë metodë konkretizimi se cila do të jetë pozita e Kosovës në marrëdhëniet ndërkombë-

bëtare dhe fillimisht çka duhet të bëjë Qeveria e Kosovës, që vendi të mos mbetet një ishull i izoluar. Në këtë vështrim janë të nevojshme një korrespondencë dhe relacione në aspektin e marrëdhënieve ndërkom-bëtare dhe mendoj se do të ishte mirë sikur Qeveria e Kosovës të kishte paraparë që të afatizohet çështja e hapjes së zyrave të Kosovës, ta zëmë në Uashington, Nju-Jork, Bruksel dhe në të gjitha qendrat e vendosjes që mendoj nuk është precizuar as afatizuar.

**Behxhet Brajshori** tha se mbetet pakashumë e paqartë se cila do të jetë mbështetja e investimeve për të arritur normën e paraparë të shtimit ekonomik. Një normë e caktuar e investimeve ekonomike kryesisht do të ishte mirë që Qeveria ta për-caktojë, e në bazë të asaj edhe të kërkojë fonde ose burime për financime të investimeve.

**RIFAT KRASNIQ** tha se dega më e rëndësishme në Kosovë dhe njëherit faktori kryesor me të cilën merren shumica e popullsisë është bujqësia, mirëpo kësaj veprimtarie ende nuk i është dhënë vendi i merituar. Mungojnë kreditë e ndryshme, si faktor mjaft i rëndësishëm për stimulimin e bujqve.

**Hajredin Kuçi** duke u ndalur në çështjet e së drejtës në Kosovë shtroj pyetjen . Cila është e drejta në Kosovë? Ne mendojmë se kemi katër lloj burime në Kosovë: i kemi ligjet para 23 marsit 89-ës, i kemi rregulloret e UNMIK-ut, i kemi ligjet e Kuvendit të Kosovës, dhe fatkeqësisht në një pjesë të Kosovës kemi edhe mund të themi edhe ligjet e Serbisë të cilat të funksionojnë. Mendoj se këtij Programi i mungon dilema apo heqja e dilemës se cila duhet të jetë e drejta në Kosovë. Në këtë program ka nevojë që të sqarohet kjo për të bërë unifikimin e sistemit juridik në Kosovë dhe homog-jemizimin e tij në tërë territorin e saj.

**Numan Baliq** tha se ato që quhen pakica të integruara e i përkasin boshnjakëve, goranëve, romëve, hashkalinjëve etj. për fat të keq ato

nuk janë të integruara..Një pjesë e mirë e tyre janë të integruara , ndoshta pak më shumë se bashkësia boshnjake dhe ajo turke. Posaçërisht, nuk janë të integruar një pjesë e madhe e bashkësisë së hashkalinjëve, egjiptasve dhe romëve. Një çështje me rëndësi për të cilën Qeveria duhet të japi përgjigje ,nëse dëshiron të jetë Qeveri e të gjithë qytetarëve, është se si programi i Qeverisë do t'ua mundësojë kthimin e pasurisë qytetarëve dhe se a është edhe në Kosovë, sikur në gjithë botën, e drejta në pasuri e drejtë e patjetër-sueshme.

**Fatmir Rexhepi** bëri vërejtje në zhvillimet dhe investimet në arsim, ku nuk jepet asnjë indeks. Duhet të dihet se sa është projekti i Qeverisë për investime në arsim, me qëllimin më të mirë që arsimi të avancohet, a mund të jetë 3, 4, 5 apo 6% e gjidip-isë së Kosovës, është mirë pra të bëhet një referencë më vonë e bilancit të punës në këtë drejtim.

Enver Hoxhaj pohoi se çdo qytetar i Kosovës ka menduar që Programi i Qeverisë aktuale do të ketë tri prior-itete kryesore: edukimi, edukimi dhe edukimi. Mjerisht kjo gjë nuk ka ndodhur. Në vendet përparimtare dhe me traditë të gjatë shkollimi dhe të studimeve universitare, edukimi sot përfaqëson prioritetin e vetëm dhe kryesor të këtyre qeverive. Programi i Qeverisë sa i përket edukimit është abstrakt, i pamat-shëm, nuk ka asnjë cak, nuk parasheh asgjë konkrete për arsimin tonë.

**Gazmend Muhaxheri** tha se në lëmin e infrastrukturës dhe të plani-fikimit hapësinor, Qeveria është marrë me konstatime, mirëpo nuk e ka bërë asnjë plan veprimi konkret në këtë lëmë. Do të duhej të ishte përgjegjësi e Qeverisë mbrojtja e rrugëve nacionale dhe e korridoreve të rëndësishme dhe strategjike.

**Lulzim Zeneli** shprehu mendimin se prioritetet janë sintetizuar me nevojat që shtrou procesi politik në vend dhe që shtrojnë proceset zhvil-limore. Implemetimi i standardeve

dhe vlerësimi pozitiv i tyre në mesin e vitit 2005 kërkon angazhimin maksimal të institucion-eve të Kosovës. Shenjat e para të këtij angazhimi veç janë dëshmuar qysh në fillim të punës së kësaj Qeverie. Një ritëm i tillë siguron se procesi i progresit në shumë fusha do të jetë evident dhe i prekshëm për qytetarët e Kosovës.

### **Bashkatdhetarët në diasporë të regjistrohën dhe të evi-dentohen si qytetarë të Kosovës**

**Qibrije Hoxha** tha se bashkatd-hetarëve tanë në diasporë duhet t'ju mundësohet e drejta e regjistrimit në mënyrë normale, d.m.th e drejta e regjistrimit në Kosovë, duke mën-juanuar procedurat tejet të komp-likuara dhe të panevojshme, të cilat ekzistojnë sot dhe të cilat vështir-sojnë dhe nganjëherë edhe u pamundësojnë mërgimtarëve tanë të lindur në Kosovë që të regjistrohën dhe të evidentohen si qytetarë të Kosovës. Kjo çështje e pazgjidhur e regjistrimit të bashkatdhetarëve tanë krijon edhe një padrejtësi për dias-porën tonë dhe kjo është e drejta e pamohueshme e bashkatdhetarëve tanë për të marrë pjesë në zgjedhjet nacionale të Kosovës, e drejtë kjo elementare njerëzore e garantuar me konventat për të drejtat e njeriut.

**Ramë Buja** përkujtoj se Kuvendi i legjislaturës së kaluar ka miratuar ligjin për kompleksin memorial "Adem Jashari" dhe për përku-jdesjen e tij dhe për bërjen e tij, ndërsa në programin qeveritar nuk është përmendur asnjë fjalë.Në vijim Buja shtroi pyetjen se a do të duhej të shihej si pjesë e reformës pushtetore në Kosovë çështja e decentralizimit? Ju e dini mirë që qeveria e mandatit të kaluar ka bërë një draft apo kornizë të këtij veprimi dhe do të ishte shumë jopërmbytësore dhe joprofitabile që të kalohet ajo. Megjithëse janë bërë lëshime, përsëri është bërë një kornizë shumë përmbytësore dhe ky decen-tralizim nuk do të duhej të ndodhë

dhe bile nuk është dashur as të thuhet, siç thuhet në program, që do të ketë mundësi të privilegjojë minoritetet, sepse unë mendoj që duke i ndarë ata nuk i privilegjojmë, por duke i ndarë i diskriminojmë.

**Fehmi Vula** u përqendrua në problemin e shëndetësisë. Në programin e mirë të Qeverisë është shkruar shumë pak dhe në viza shumë të trasha për këtë, prandaj është shumë vështirë që sot ta elaborojmë këtë problematikë. Një gjë është e vërtetë se shëndetësia e Kosovës ka nevojë shumë të madhe për një shërim të mirëfilltë.

**Ibush Jonuzi** tha se jemi Ministria e Energjetikës duhet të bëjë maksimumin e mundshëm për të mposhtur kancerin e krijuar të energjisë elektrike në Kosovë.

**Fehmi Mujota** duke kujtuar premtimin e dhënë para elektoratit të PDK-së se çështja e parë që do t'ia adresojë Kuvendit të Kosovës është ngritja e kompleksit përkujtimor në Reçak dhe atij në Prekaz, tha se duke pasur parasysh se në Kosovë ka mundësi sipas paragjyqimeve të ketë tepriçë buxhetore, atëherë që tani të zëmë hapin, që të paktën për vitin 2005 të parashikojmë mjete buxhetore në shumën prej 3 milionë euro për Prekazin, 2 milionë euro për Reçakin dhe 1 milion euro për varrezat e dëshmorëve anë e kënd Kosovës.

**Fatmire Mulhaxha Kollqaku** tha se Programi Qeveritar duhet të përqëndrohet shumë më tepër në implementimin e Ligjit të shëndetësisë, gjegjësisht në mbikëqyrje dhe kontroll të veprimtarisë shëndetësore, si asaj publike, ndërsa në veçanti të asaj private.

**Fadil Kryeziu** i propozoi Qeverisë që t'i qaset skemave sociale që përmenden në programin e saj dhe në këtë plan pra të rishqyrtohen. Ndonjëherë krijohet përshtypja që ne do të krijojmë një shtet social dhe shpeshherë kategoritë që marrin ndihma sociale dalin kategori që përfitojnë më së shumti nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Përveç ndihmave sociale që marrin, ata

lirohen nga pagesat e rrymës, nga pagesat e shërbimeve të tjera komunale dhe del që njerëzit që punojnë duhet të jenë më të diskriminuar.

**Fetah Berisha** duke folur rreth paralelizmit në arsim tha se tha se minoriteti serb duhet integruar realisht në sitemin arsimor të komunave tona. Ata janë të integruar vetëm në aspektin teknik pra ne meremetojmë shkollat, pajisim, ndërsa në aspektin pedagogjik nuk janë të integruar dhe nuk bashkëpunojnë me drejtoritë komunale të arsimit.

**Genc Gorani** tha se megjithë faktin se sektori i informatikës dhe telekomunikacionit në mbarë botën është një prej sektorëve më dinamikë, faktikisht me dinamikë më të lartë të zhvillimit, me rëndësi strategjike për të gjithë sektorët tjerë shoqëror dhe ekonomik, sektor transformues i shoqërive moderne i ndërlidhjes dhe të interakcionit përbrenda vendit dhe me vendet tjera, këtij sektori i është përkushtuar vetëm një fjali dhe atë në një formë gjenerike që nuk iu shpije askund.

**Gani Koci** tha se Programi nuk definon në mënyrë të qartë objektivat për mandatin që ka marrë. Nuk përcakton mënyrat konkrete të realizimit të objektivave, bartësve të detyrave, afatet dhe në fund përgjegjësitë e secilës ministri veç e veç. Qoftë edhe në vija të trasha, nuk janë të njohura planet konkrete dhe operacionalizuese të prioritetëve që shtron ky material. Mënyra e përpilimit të tij dhe e shtruarjes me kaq lehtësi në Kuvend, lë të kuptohet, që në start të punës së kësaj qeverie, ikjen nga çfarëdo përgjegjësie dhe llogaridhënie..

**Safete Hadëraxonaj** shprehu mendimin se nga ajo që është thënë për turizmin dhe shërbimet fitohet përshtypja se hartuesi nuk ka analizuar se në çfarë shkalle të zhvillimi është turizmi, nuk ka vizionin se kah do të shkojë kjo degë e rëndësishme e ekonomisë dhe si duhet të arrijë në cakun e dëshiruar.

**Nazim Jashari** theksoi se megjithëse Qeveria në Programin e vet paralajmëron aprovimin e

strategjisë për zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor dhe rural në Kosovë, që mendoj se është për t'u përshëndetur, një aspekt negativ i kësaj është se nuk është bërë afatizimi kohor i miratimit të kësaj strategjie.

**Bajrush Xhemajli** vuri në spikamë se fokusimi i Qeverisë në ndërmarrjen e masave efektive në stabilizimin e prodhimit të furnizimit dhe ngritjes së nivelit të pagesës së energjisë së harxhuar është i gabueshëm, këtë duhet ta bëjnë 10 mijë punëtorë ekspertë të punësuar në KEK bashkë me menaxhmentin e tyre. Qeveria do të duhej të merret me punë tjera, ajo duhet t'i përkrahë iniciativat dhe aktivitetet që mundësojnë ngritjen e nivelit të gadishmërisë për prodhim më cilësorë, për furnizim të rregullt me energji elektrike, duke insistuar me gjetjen e mekanizmave shtetërorë në përmirësimin apo eliminimin e dukurive prezente, në mospagesën e energjisë së hargjuar.

**Sabit Rrahmani** propozoi që për të gjitha institucionet që do të privatizohen, fjala është për ndërmarrjet private, ato publike dhe aksionare, Kuvendi dhe kjo Qeveri ta nxjerrë një lligj të posaçëm dhe t'i kushtëzojë këto, që 10% të punëtorëve të jenë nga radhët e komuniteteve pakicë.

**Ramush Haradinaj** tha se duke i pranuar vërejtjet dhe kritikën, por edhe ndihmesën që janë të mirëseardhura, unë premtoj se kjo do të jetë një materie ndihmesë, në zbatim të Programit. Pra një materie ndihmesë në zbatim të Programit si Qeveri. Po ashtu disa nga ato sugjerime që janë të inkompatueshme dhe që e pasurojnë Programin do të jenë të përfshira në planet dhe në programet veç e veç të ministrive.

**Nexhat Daci** konstatoi se seanca e sotme plenare, vërtet meriton vlerësimet më të larta si seancë plenare. Të gjitha diskutimet ishin cilësore dhe në nivel të duhur.

**Në vijim për aprovimin e Programit të Qeverisë votuan 66 deputetë, 1 votë ishte kundër dhe 31 abstenime.**





*Studentë të UE-së gjatë vizitës në mjediset e Kuvendit të Kosovës*